

Përse myslimanët kanë mbetur prapa e të tjerët kanë përparuar?

EMIR SHEKIB ARSLAN



Emir Shekib Arslan

**PËRSE
MYSLIMANËT
KANË MBETUR
PRAPA E TË
TJERËT KANË
PËRPARUAR**



Mitrovicë
1417/1997

Përktheu nga boshnjakishtha:
Muhamed Iljaz Dolaku

Redaktor gjuhësor:
Mr. Mehdi Hyseni

Parathënie

Në emër të All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit. “Me të vërtetë, All-llahu nuk do ta ndryshojë gjendjen e një populli, derisa ai të mos e ndryshojë vetveten”. (Er-Ra’d: 11)

“Kjo është për arsye se All-llahu nuk ia prishë popullit mirësitë që ia ka dhuruar - përderisa ata të mos i prishin sjelljet e veta.” (El-Enfal: 53).

“Ne, me të vërtetë, do t’u ndihmojmë Pejgamberëve Tanë dhe atyre që besojnë - në jetën e kësaj bote dhe (atë) Ditë, kur do të sillen dëshmitarët (Ditën e Kiametit).” (El-Mu’min: 51).

“Besimtarë të vërtetë, janë vetëm ata që besojnë All-llahun dhe Pejgamberin e Tij, dhe pastaj nuk dyshojnë dhe luftojnë në rrugën e All-llahut me pasurinë dhe jetën e tyre. Këta janë besimtarë të singertë.” (El-Huxhurat: 15).

Nxënësi im Shejh Muhammed Bisjuni Imran, imam i muharaxhit të ujdhesës Sambas Borneo (Javë), më shkruajti një letër me anë të së cilës propozon që, vëllai ynë, luftëtar, mbret i elokuencës, me pendën e tij të bujshme të shkruajë për “El-Menar” një shqyrtim për shkaqet e dobësisë së myslimanëve në kohën e tanishme dhe për shkaqet e fuqisë, pushtetit, zotërimit, forcës dhe pasurive të evropianëve dhe japonezëve. Në një letër tjetër thotë se ka lexuar atë që shkruajmë ne përkritazi me komentarin e Kur’anit, që botohet

në “El-Menar”, duke i parashtruar shkaqet e kësaj gjendjeje. Më tutje thekson se ka lexuar edhe atë që përkitazi me këtë temë ka shkruar Shejh Muhammed Abduhui në artikujt e tij “Islami dhe krishterimi sipas shkencës dhe qytetërimit”, porse ka dëshirë që në lidhje me këtë të shkruajë diçka edhe mbreti i elokuencës (Shekib Arsllani) me pendën e tij autoritative i cili tregon sheshit dijeninë e tij të gjerë dhe pjekurinë e mendimit të tij, në mënyrë që ndoshta të përtëritet efekti në shpirtin e myslimanëve me atë që i përgjigjet të tanishmes së tyre, e t’ua tërheqë vërejtjen të pakujdesshmëve, t’i udhëzojë të paudhëzueshmit, t’i vë në livizje të tërhequrit dhe t’i inkurajojë aktivët. Propozimin e vet e mbështet në çështjet e përmendura, të cilat i kanë dhënë shkas të painformuarve të dyshojnë në besim, ngase ai di, në bazë të asaj që ka dëgjuar gjatë ligjërimeve tona në entin “Medresetu’d da’veti ve’l-irshadi” dhe nga ajo që kemi shkruar më shumë herë në “El-Menar” dhe në komentarin e Kur’anit, se, përkatësisht, Kur’ani është kundër atyre që pretendojnë se janë myslimanë (të ashtuquajturve myslimanë), e ata nuk mund të jenë argument kundër tij (d.m.th. se Islami do të gjykojë sipas Kur’anit e jo sipas të ashtuquajturve myslimanë).

Ky propozim më dha gjasë që mikut dhe vëllait tim Emir Shekibin t’ia mbushë mendjen që të shkruajë diç në këtë kuptim për “El-Menar”, andaj, menjëherë ia dërgova letrën e Shejh Muhammed Bisjunit, posa më erdhi ajo, përkundër faktit se vetë e këshilloja që të lirohet nga shkrimi i shumtë, ngase

bashkëpunon me revista të ndryshme të Lindjes dhe të Perëndimit, dhe u shkruante shumë miqve dhe shokëve të vet. Për shkak se ishte tepër i zënë, e prolongojë përgjigjen e vet derisa të kthehej nga udhëtimi i fundit në Spanjë. Në këtë udhëtim mbresa të mëdha i kishin lënë dëshmitarët e fundit të kulturës arabe në Spanjë dhe Maroko si dhe aksionet e Francës që t'i krishterizojnë berberët në Maroko, në mënyrë që t'ia hapin rrugën krishterizimit të arabëve në Afrikë, të cilët fatkeqësisht kishin rënë nën robërimin e tyre, ashtu siç patën bërë spanjollët me të parët e tyre në Spanjë. Nën mbresën e këtyre fakteve shkroi këtë përgjigje, e cila doli vepër e përkryer e elokuencës së tij, edhe një dëshmi e mençurisë së tij, ndoshta më e dobishme prej gjithë asaj që ka dhënë veprimtaria dhe ndërmarrja e tij e që ka rrjedhur nga burimi i informimit të tij dhe që ka rezultuar nga penda e tij. All-llahu e shpërbleftë me më të mirin shpërblim, me të cilin i shpërblenë luftëtarët e singertë.

Letra e shejh Muhammed Bisjuni Imranit

Zotëri profesorit tim të nderuar dhe rilindasit të madh, zotëri Muhammed Reshid Rida, pronarit të “El-Menar-it”, - Dhashtë Zoti që unë dhe myslimanët të nxjerrim fitim nga jeta e tij e çmueshme, amin!

Mbi Ju qoftë shpëtimi, mëshira dhe bekimi i Zotit! Ai që i ka lexuar artikujt kumbues përkitazi me tema të ndryshme që i

ka shkruar në “El-Menar”, politikani shumë i ditur dhe i famshëm, mbret i elokuencës, Emir Shekib Arslanit, e di se ai është njëri ndër shkrimtarët më të mëdhenj islam të cilët luftojnë për Islam dhe se është mbështetje më e fortë e “El-Menar-it” dhe pronarit të tij në shërbim të Islamit dhe myslimanëve. E lus Zotin e Lartmadhërishëm që të dyve t’u japë jetë të gjatë, të mirë e të shëndetshme, ashtu siç e lus zotëri profesorin, pronarin e “El-Menar-it”, që të kërkojë prej Emirit, shkrimtarit të madh, që të denjojë të më përgjigjet në këto pyetje:

1) Cilët janë shkaqet e dobësisë dhe të prapambetjes së myslimanëve përgjithësisht nga pikëpamja profane dhe fetare, e posaçërisht të myslimanët e Javës dhe Malezisë, që jemi bërë të pavlershëm pa kurrfarë fuqie dhe force, ndërsa Zoti i Lartmadhërishëm thotë në Kur’an: “Prestigji i takon vetëm All-llahut, Pejgamberit të Tij dhe myslimanëve.” Ku është sot prestigji (nami) i myslimanëve? A mund të pohojë myslimani se është i shquar përderisa është i poshtëruar, i përbuzur, pa kurrfarë mjeteesh prestigji, vetëm për shkak se Zoti thotë: “Prestigji i takon vetëm All-llahut, Pejgamberit të Tij dhe myslimanëve”?

2) Cilët janë shkaqet e përparimit jashtëzakonisht të madh të evropianëve, amerikanëve dhe japonezëve? A do të mund të ishin edhe myslimanët sikurse ata në këtë përparim po që se do t’i qaseshin mjeteve të tyre duke iu mbajtur fesë së vet (Islamit), apo nuk do të mundeshin?

Kaq, me dëshirë që Emeri të denjohet të parashtrojë përgjigjen e vet në këto pyetje në “El-Menar”, për çka Zoti do ta shpërblejë begatshëm atë dhe pronarin e “El-Menar-it”.

ambas, Borneo Perëndimor,

ë 21 rebiu'l-ahir 1348

Përgjigjja e Emir Shekib Arslanit

Prapambetja dhe dobësia e myslimanëve nuk janë kufizuar vetëm në Javë dhe në ujdhesat e Malezisë, e as në ndonjë vend tjetër të caktuar, porse kjo prapambetje përfshinë Lindjen dhe Perëndimin, vetëm që shkalla e prapambetjes së tyre është e ndryshme, ngase disa janë zhytur thellë e disa gati sa nuk janë përmbytur, disa gjenden në rrezik tejet të madh e disa në më të vogël. Thënë shkurtimisht, gjendja e tanishme e myslimanëve, e veçanërisht në shekullin XIV sipas Isait a.s., nuk mund ta kënaq as njeriun i cili është tejet i flakët për Islam dhe i cili është më së shumti i ngazëllyer me ithtarët e tij, e le më ta kënaq njeriun indiferent. Gjendja e tyre e tanishme nuk kënaq as nga aspekti fetar as nga ai profan, as nga aspekti material as nga ai shpirtëror. Në ato vende ku myslimanët jetojnë së bashku me të tjerët, me siguri do të vërejnë se kanë mbetur

prapa tyre, andaj pak sish mund të krahasohen me ta dhe unë nuk di për asnjë vend në këtë shekull ku myslimanët jetojnë të përzier me konfesionet e tjerë e të mos jenë mbetur mbrapa tyre. Porse vetëm disa bëjnë përjashtim në këtë, si për shembull boshnjakët, myslimanët e Bosnjës, të cilët nuk janë në nivel më të ulët nga bashkëqytetarët e vet katolikë apo ortodoksë, as shpirtërisht as materialisht, por në këtë ua tejkalojnë atyre. Në gjendje të njëjtë janë edhe myslimanët rusë, prej të cilëve bashkëqytetarët e tyre të krishterë nuk janë aspak më të zhvilluar, ndërsa myslimanët e Azerbajxhanit para luftës kanë qenë më përparimtarë nga qytetarët e vet të sekteve të ndryshme krishtere. Veç kësaj, myslimanët kinez pa dyshim, me gjithë prapambeturinë e tyre janë më përparimtarë se bashkëqytetarët e vet kinezët budistë. Kështu qëndron çështja, nëse deri më sot nuk janë ndërruar raportet ndërmjet tyre, siç ka qenë para luftës. Në vendet e tjera myslimanët kanë mbetur mbrapa nga bashkëqytetarët e vet përgjithësisht, megjithëqë ekzistojnë dallime në shkallën e prapambetjes së tyre.

Thuhet se arabët në gadishullin e Singapurit janë më të pasur se të gjithë bashkëqytetarët e tyre, madje më të pasur se edhe vetë anglezët në përpjestim me fuqinë numerike të tyre, porse nuk e kam të njohur se sa është i saktë ky lajm. Edhe nëse pandehim se kjo është e vërtetë, megjithatë kjo aspak nuk e ndryshon bilancin e përgjithshëm të myslimanëve.

Nuk mund të mohohet se në botën islame ekziston lëvizja e fuqishme dhe se bëhen përpjekje të mëdha nga aspekti material

dhe shpirtëror, ndihet zgjimi që meriton admirim të cilin e kanë vërejtur evropianët dhe e kanë vlerësuar ashtu si duhet, andaj disa që tani frikësohen nga pasojat e këtij zgjimi. Kjo frikë vërehet ndërmjet rreshtave të shtypit evropian. Vetëm se ky përparim nuk i ka barazuar myslimanët me asnjë popull të Evropës, Amerikës apo Japonisë.

Pas këtij konstatimi duhet shqyrtuar dhe hulumtuar shkaqet që kanë sjellur gjer tek kjo prapambetje në botën islame pasi që myslimanët një mijë vjet kanë avancuar dhe kanë qenë sundues të cilëve ua kanë pasur frikë dhe fjala e të cilëve është dëgjuar prej të gjithë popujve në Lindje dhe në Perëndim. Prandaj, para se t'i qasemi hulumtimit të shkaqeve të prapambetjes, duhet t'i hulumtojmë shkaqet e përparimit.

Shkaqet e përparimit të myslimanëve në të kaluarën

Shkaqet e përparimit të myslimanëve në të kaluarën kryesisht reduktohen (përmbledhen) në fenë islame, e cila sërish është paraqitur në Gadishullin Arabik, të cilën atëbotë e përqaftuan fiset arabe, dhe sipas intencës së saj e braktisën përçarjen, e pranuan bashkimin, e flakën idolatrinë, pranuan qytetërimin, e hudhën vrazhdësinë, përqaftuan merhametin, braktisën adhurimin e idhujve, u dhanë në adhurim të vetëm Një Zoti dhe shpirtërisht në tërësi u rilindën, kështu që arritën gjer tek autoriteti, fama, dituria, pasuria dhe për gjysmë

shekulli pushtuan gjysmën e rruzullit tokësor. Sikur ndërmjet tyre të mos ndodhte përçarja qysh para fundit të kalifatit të Uthmanit dhe gjatë kalifatit të Aliut, do ta kishin pushtuar tërë botën e që askush të mos mund t'u kundërvihet. Me gjithë luftërat ndërmjet Aliut dhe Muaviut, pastaj ndërmjet Umejëve dhe Ibën Zubejrit, sukseset pushtuese të myslimanëve të cilat i kanë arritur për gjysëm përkatësisht dy të tretat e shekullit, i kanë mahnitur intelektualët historianë dhe i kanë habitur pushtuesit e mëdhenj dhe e kanë shastisur më të madhin ndër ta Napoleon Bonapartën, i cili veçanërisht e ka pranuar këtë.

Pra, Kur'ani i ka rilindur Arabët përsëri dhe i ka shpën nga siujdhesa me shpatë në njërin dorë kurse me Kur'an në dorën tjetër, duke pushtuar dhe sunduar nëpër botë.

Nuk mund të mirret parasysh ajo që thuhet për arabët para Islamit, kur përmenden pushtimet e tyre dhe kur vlerësohet morali i lartë i tyre në kohën pagane. Diç të tillë vërtetë ka pasur, dhe gjurmët shihen edhe sot e kësaj dite, prandaj nuk ka dyshim në kulturën e vjetër arabe, e cila bënë pjesë ndër më të vjetrat në botë. Për më tepër, mbretëron mendimi se shkrimi është shfaqur më së pari tek ata. Mirëpo, rrethi i asaj kulture ka qenë i ngushtë dhe i kufizuar në Gadishullin Arabik dhe në fqinjësinë e tij, ndërsa ekzistojnë periudha kur mbi arabët kanë qeverisur edhe të huajt, të cilët kanë sunduar në tokat e tyre dhe të cilët i poshtëronin në vatrat e tyre, si Persianët në Jemen, Umman dhe Hira, Abisinasi po ashtu në Jemen ndërsa Romakët në periferi të Hixhazit dhe në Siri. Në realitet, ata as

që kanë pasur pavarësi të plotë përderisa nuk e përqaftuan Islamin, gjer atëherë popujt e largët nuk i njihnin ata, nuk iu nënshtroheshin atyre, e as që flisnin për fuqinë e tyre, dhe Muhammedi a.s. është ai, i cili në histori i ka shpën në radhë të parë të pushtuesve.

Për këtë shkak jemi të obliguar të kërkojmë dhe ta hulumtojmë shkakun me ndihmën e të cilit myslimanët kanë përparuar, kanë pushtuar, kanë sunduar, kanë ndërtuar dhe kanë arritur këtë shkallë të famës dhe përparimit, dhe jemi të shtrënguar që këtij hulumtimi t'i kushtojmë kujdes të madh në mënyrë që të bindemi se a ekziston ende ky shkak tek arabët, e së bashku me ta mbeten prapa edhe nxënësit e tyre, myslimanët e tjerë, apo ndoshta tek ata është zhdukur ky shkak kurse nga besimi nuk ka mbetur asgjë pos vetë emrit, asgjë nga Islami pos gjurmëve, asgjë nga Kur'ani pos mësimi pa sjellje sipas tij, dhe gjërave të tjera të cilat kanë ekzistuar në fillim të Islamit.

Pasi që ta shqyrtojmë mirë e mirë çështjen, do të shohim se pa dyshim është zhdukur ai shkak me ndihmën e të cilit myslimanët kanë përparuar, e nëse edhe ka mbetur diç prej tij, ajo është sikurse gjurmët e tatuazhit në dorë. Sikur Zoti t'u premtonte myslimanëve renome vetëm për shkak emrit të tyre e pa kurrfarë punësh e ndërmarrjesh, atëherë do të kishim të drejtë të themi: “Ku është prestigji i myslimanëve që përmendet në ajetin: “Prestigji i takon vetëm All-llahut, Pejgamberit të Tij dhe myslimanëve”? - Sikur Zoti të thoshte: “E kemi obligim t'i ndihmojmë myslimanët” dhe në këtë kuptim t'i ndihmojë pa

kurrfarë virtytesh të tyre, përveç që pohojnë se janë myslimanë, atëherë vërtetë do të kishte vend për t'u çuditur përse i lë kështu në "baltë" pas premtimit të prerë. Mirëpo, citatet e Kur'anit janë ndryshe, ngase Zoti nuk do ta shkelë premtimin e Vet, ndërsa Kur'ani nuk ka ndryshuar aspak, por ndërrimi ekziston vetëm tek myslimanët, për çka Zoti na ka tërhequr vërejtjen me fjalë: "Me të vërtetë, All-llahu nuk do ta ndryshojë gjendjen e një populli, derisa ai të mos e ndryshojë vetveten". Pasi që myslimanët kanë ndryshuar, do të ishte për t'u habitur sikur Zoti të mos ua ndryshonte atë që kanë pasur përpara, të mos ua jepte poshtërimin dhe mizerien në vend të renomesë dhe madhështisë, kjo do të ishte në kundërshtim me drejtësinë e Zotit, e Zoti është drejtësia vetë.

Si mund të shpresosh se Zoti do ta ndihmojë një popull pa kurrfarë pune të tij dhe se do t'ia dhurojë ato begati të cilat ia ka dhuruar të parëve të tij, pasi që ai popull i ka braktisur të gjitha punët që i kanë ndërmarrë ata, e vetëm Zoti është i Plotfuqishëm dhe vetëm Ai bënë gjithçka që është më vend. Si mund të paramendohet prestigji pa kurrfarë shkak, korja pa lërim dhe mbjellje, suksesi pa punë dhe zell dhe ndihmesa pa kurrfarë shkak për të? Pa dyshim, sikur të ishte kështu, kjo do t'i shtyente njerëzit në dembeli, do t'i largonte nga çfarëdo pune qoftë, madje kjo do të ishte në kundërshtim me ligjet natyrore në bazë të cilave Zoti e ka vendosur tërë botën dhe nuk do të kishte dallim në mes të vërtetës dhe të pavërtetës, dëmit dhe dobisë, e Zoti është larg asaj që ta bëjë këtë. Sikur Zoti ta

ndihmonte dikë pa kurrfarë angazhimesh, me siguri do ta ndihmonte Pejgamberin e Vet, Muhammedin a.s, e nuk do ta bënte të nevojshëm që të luftojë, të përpiqet dhe t'i nënshtrohet ligjeve natyrore për t'ia arritur qëllimit. Paramendoje një popull që i ka njëqind obligime ndaj Zotit, e ai i përmbush vetëm pesë, a mund të konsiderojë se ai i ka kryer të gjitha obligimet e veta dhe a mund të shpresojë asi shpërblimi çfarë kanë fituar të parët e tij, të cilët i kanë përmbushur obligimet e veta qind për qind, apo edhe nëse jo qind për qind, së paku i kanë përmbushur 90 ose 80 prej njëqindve? Jo. kjo do të ishte në mospajtim me atë që Zoti ka premtuar përmes Pejgamberëve të Tij, do të kundërshtohet me arsyen dhe logjikën dhe ky nuk është ai kusht që ua ka dedikuar Zoti myslimanëve dhe kjo nuk është ajo shitblerje me të cilën myslimanët janë përgëzuar. Përkatësisht, Zoti thotë: ***“All-llahu, me të vërtetë, ka blerë nga besimtarët e vet shpirtërat dhe pasuritë e tyre, për t'iu dhuruar Xhennetin atyre. Ata luftojnë në rrugën e All-llahut, vrasin dhe vriten. (Ky është) premtim i Tij i vërtetë në Teurat, në Inxhil edhe në Kur'an. E, kush është më i plotë (më konsekuent) se All-llahu në premtim?! Andaj gëzojuni kësaj shitblerjeje të juaj, që e keni kontraktuar me Të, dhe kjo është fitore e madhe!”***. (Et-Teube: 111). Ku është gjendja e sotme e myslimanëve sipas këtij përshkrimi të Kur'anit dhe ku janë ata ndaj të parëve të tyre të cilët kanë nxituar në vdekje, të vdesin me vdekjen martire, sikur shehidë?! Ata shumë herë kanë kërkuar vdekje të tillë, mirëpo nuk kanë mundur ta gjejnë atë.

Kalorësi i tyre sulej në armikun duke klithur: “Unë po e ndiejë aromën e Xhennetit!”, - dhe gjithnjë sulmonte dhe futej në vendet më kritike të fushëbetejës, derisa nuk vritej. Atëherë thoshte: “Kjo është ditë gëzimi!” E, nëse përkundër dëshirës së madhe të tij nuk vritej në betejë, atëherë kthehej i pikëlluar.

Krahasimi mes myslimanëve të sotëm dhe evropianëve

Sot myslimanët apo shumica prej tyre kanë humbur trimërinë që posedonin të parët e tyre, e këtë trimëri e kanë fituar armiqtë e Islamit, të cilën nuk e porositë shkrimi i shenjtë i tyre, andaj i shohim ushtritë e tyre se si garojnë duke u sulur në vdekje, duke i përqaftuar heshtat dhe bajonetat. Çdonjëri e ka të njohur se vetëmohimi i tyre në Luftën Botërore, ku flijonin veten dhe çdo gjë më të çmueshme që kishin, kanë qenë mbi aftësinë e konceptimit të arsyes njerëzore. Gjermanët për shembull kanë humbur rreth dy milion njerëz, francezët një milion e katërqind mijë, anglezët gjashtëqind mijë, italianët katërqind e gjashtëdhjetë mijë, rusët janë vlarë në numër të shumtë etj. Këto janë sakrifica në jetën e njerëzve, e për sa i përket sakrificave materiale Anglia i ka shpenzuar shtatë miliardë monedha ari ose shtatë mijë miliardë funta, Franca rreth dy miliardë, Gjermania tre, Italia pesëqind milionë ndërsa Rusia ka shpenzuar aq shumë sa që kjo ka shkaktuar urinë e

cila ka sjellur gjer tek revolucion, e më vonë gjer tek bolshevizmi, etj.

Le të më thotë dikush se cili popull mysliman sot do të shkonte aq larg siç kanë shkuar këta të krishterë në sakrificën e njerëzve dhe të pasurisë pa hesap për shpëtimin e atdheut dhe shtetit të vet, e atëherë çuditemi përse Zoti u ka dhënë atyre fuqi, madhështi dhe pasuri, e përse myslimanëve nuk u ka dhënë madje edhe një pjesë prej tyre?!

Do të mund të thuhet se myslimanët janë të varfër, se nuk kanë aq pasuri që ta japin në ato përmasa. Ne do të përgjigjeshim në këtë se të gjitha shpenzimet do t'i ndanim në evropianët sipas kapitalit kryesor të tyre, e nga myslimanët nuk do të kërkonim që të japin proporcionalisht më tepër se sa që kanë dhënë evropianët. Pra, a do të mundnin popujt e sotëm myslimanë të japin vullnetarisht aq sa kanë dhënë popujt evropianë, prej të cilëve disa në Luftën Botërore kanë shpenzuar më tepër se gjysmën e pasurisë së vet? Përgjigjja në këtë është negative, ngase sot ndër myslimanët nuk ekzistojnë as individë as popuj që do ta bënin këtë.

Do të mund të thuhet se turqit, e ata janë myslimanë, kanë shpenzuar gjithë çka kanë mundur në luftë kundër grekëve, dhe se aspak nuk kanë mbetur mbrapa evropianëve në flijimin e njerëzve dhe gjërave me vlerë të madhe. Kështu është, kjo edhe ka ndodhur kështu. Disa turq në këtë luftë kanë shpenzuar një të tretën e disa gjysmën e pasurisë së vetë, mirëpo kur e kanë bërë këtë, kanë fituar dhuntinë e Zotit dhe kanë ngadhënjyer,

janë bërë të pavarur dhe janë ngritur pasi që ishin të rrëzuar, janë bërë të famshëm pasi që nuk ishin kurrfarë vlere, e edhe popujt islamë, sikur të vepronim në sakrificë sipas urdhrit të Kur'anit, siç kanë vepruar të parët e tyre, ose së paku sikur t'i pasonin evropianët në këtë aq sa ata sot flijojnë njerëz dhe pasuri për mbrojtjen e atdheut të tyre, që ta mbrojnë nga armiku, nuk do të vjelnin ata fryte tjera por të njëjtat sikurse edhe të tjerët. Edhe ata do ta arrinin dhuntinë e Zotit dhe nuk do t'i godiste kurrfarë fatkeqësie.

Mirëpo, popujt islamë dëshirojnë që ta ruajnë pavarësinë e vet pa kurrfarë sakrificash, pa e flijuar vetveten, pa garim në vdekje, pa luftë me pasurinë e vetë dhe kërkojnë ndihmë nga Zoti në mënyrë tjetër nga ajo që Ai ka kushtëzuar, sepse Zoti i Lartmadhërishëm thotë:

“Me të vërtetë, All-llahu e ndihmon atë, i cili ndihmon Ate” dhe “nëse ndihmoni All-llahun, edhe Ai do t’ju ndihmojë juve dhe do t’ua mundësojë përparimin tuaj.”

Është e ditur se Zoti nuk ka nevojë për ndihmën e askujt, porse me të ndihmuarit e Zotit nënkuptohet nënshtrimi ndaj urdhrave të Tij dhe ngurrimi nga ndalesat e Tij. Myslimanët i kanë lënë pas dore dhe i kanë braktisur të gjitha apo shumicën e atyre që u ka urdhëruar Kur’ani (në këtë drejtim), duke shpresuar se do ta meritojnë ndihmesën e Zotit vetëm me atë se janë myslimanë, që e besojnë Zotin Një dhe mendojnë se vetëm kjo është e mjaftueshme e që të mos luftojnë me jetën dhe pasuritë e tyre. Disa shpresojnë në lutjet që ia drejtojnë të

Gjithmbarshmit, ngase këtë e kanë më lehtë se sa të luftojnë dhe të japin nga pasuria vet.

Sikur të mundej që vetë lutja ta zëvendësojë luftimin, me këtë do të kënaqej edhe Pejgamberi i Zotit, shokët e tij dhe myslimanët e parë, ngase ata kanë qenë kategori e myslimanëve të cilët më së shumti kanë merituar që Zoti t'ua pranojë lutjen. Sikur të mundej që dëshira të prokurohej me lutje dhe pranimin e Zotit pa punë dhe vepra, do të trazoheshin ligjet natyrore, do të shkatërrohej legjislacioni, e Zoti nuk do të thoshte: ***“Secilit njeri do t'i plotësohet ajo që e ka punuar vetë”*** dhe nuk do të thoshte ***“Dhe thuaj: “Punoni, All-llahu, Pejgamberi i Tij dhe besimtarët do të shohin punën tuaj.”***; nuk do t'u thoshte atyre të cilët kërkonin ndjesë për mospjesëmarrjen në luftë: ***“Mos u arsyetoni, sepse, na nuk ju besojmë, meqë All-llahu na ka lajmëruar për qëllimet e juaja. Me siguri, All-llahu dhe Pejgamberi i Tij do t'i shohin veprat tuaja.”***; dhe nuk do të thoshte: ***“Unë, nuk ia humbi mundin asnjë punëtori nga ju”***.

Mandej, shumë myslimanë mendojnë se janë myslimanë me vetë faljen e namazit, e që nuk i ngarkon ta sakrifikojnë jetën, pasurinë dhe në bazë të kësaj shpresojnë ndihmën e Zotit. Nuk është kështu. Dispozitat e Islamit nuk janë të kufizuara vetëm në namaz, agjërim, lutje dhe pendim. E, si do ta pranojë Zoti lutjen e atyre të cilët nuk dojnë të shkojnë në luftë porse gjejnë arsye të tërhiqen, e do të mundnin të aktivizoheshin dhe të ndihmonin me pasurinë që kanë?!

Thonë se myslimanët nuk posedojnë aso pasurish dhe begatish çfarë posedojnë evropianët, që të mund t'i harxhojnë ato për qëllime mirëbërëse dhe të ndihmohen ndërmjet veti. Ne përgjigjemi se ne do të pranohim që ata të shpenzojnë proporcionalisht (përpjesëtimisht) sipas kapitalit të vet, siç kemi thënë më herët kur ishte fjala për luftën me pasuri (pronë). Por, a e bëjnë këtë myslimanët?

Për më tepër, ne shohim që myslimanët kanë zhdukur dhe kanë shkatërruar atë që ka mbetur nga vakufet dhe institucionet humanitare që ua patën lanë të parët, e le më që të japin diç nga prona personale dhe të shkojnë krahas evropianëve në gatshmëri për sakrificë për të mirën e institucioneve, e atëherë, si mund të dëshirojnë myslimanët që të kenë begati, fuqi dhe pushtet sikurse evropianët, duke qenë se ngecin shumë prapa vetëmohimit dhe sakrificës?! Puna për të arritur pushtet në Tokë është sikurse bujqësia: aq sa kujdesesh dhe punon tokën, aq edhe do të japë ajo; nëse ti e pakëson punën tënde, edhe ajo do t'i pakësojë redimentet e veta. Myslmanët do të dëshironin të kenë pushtet çfarë kanë evropianët, pa vetëmohime dhe pa sakrificë, duke mos humbur asgjë nga kënaqësitë e veta, e harrojnë se Zoti thotë:

“Ne gjithsesi do t’ju sprovonim me diçka nga frika dhe uria, edhe me humbje të pasurisë dhe të jetës e të fruteve. Dhe ti përgëzojë durimtarët”. (El-Bekare: 155)

Myslmanët do të mund të thonin se kanë shijuar sakrificën, se tanimë janë vuar në sprovë me humbjen e

pasurisë, jetës dhe fryteve dhe se kanë qenë të durueshëm, porse kjo nuk u ka sjellur asgjë, e as që janë liruar nga zgjedha e robërisë evropiane. Këtë e përmendim ngase këtë e kam dëgjuar me veshët e mi prej shumë myslimanëve. Përgjigjen në këtë vërejtje të tyre është: A mund të na thonë ata se kontributet dhe sakrificat e tyre në këtë pikëpamje i përgjigjen asaj çka bëjnë të krishterët dhe hebrenjtë? Jo, porse qëndrojnë në përpjesëtueshmëri 1:100.

Kemi një shembull të freskët (nga e kaluara e afërt), e kjo është çështja palestineze. Në Palestinë kanë ndodhur ngjarje të përgjakshme ndërmjet arabëve dhe hebrenjve, në të cilat janë vrarë shumë veta edhe në njërin edhe në tjetrën anë. Me këtë rast hebrenjtë nga të gjitha anët e botës u kanë dërguar ndihma hebrenjve që kanë rënë viktimë në Palestinë, ndërsa edhe bota myslimane, natyrisht, ka dashur që t'i ndihmojnë arabët e Palestinës. Kontributet vullnetare që ua kanë dërguar hebrenjtë vëllezërve të vet në Palestinë kanë arritur shumë prej një milion funtash, ndërsa të gjitha kontributet vullnetare të myslimanëve kanë arritur trembëdhjetë mijë funta, përkatësisht afro një e njëqinda pjesë.

Me siguri do të thuhet se myslimanët nuk janë të pasur si hebrenjtë. Në përsëri do të përgjigjem se ne pranojmë që ata të sakrifikojnë sa edhe hebrenjtë dhe evropianët, në përpjesëtueshmëri me pasurinë e tyre, e nuk do të kërkojmë nga të varfërit, të cilët nuk kanë asgjë më tepër se sa që u nevojitet për shpenzimet shtëpiake. Zoti thotë në Kur'an:

“Nuk është mëkat mos të shkojnë në luftë - të dobët (fizikisht), as të sëmurët, as ata që nuk mund të sigurojnë shpenzimet, nëse janë të sigurtë ndaj All-llahut dhe Pejgamberit të tij. S’ka arsye t’u bëhet asnjë vërejtje bamirësve. Se, All-llahu është falës dhe mëshirues.”
(Et-Teube: 91).

Pastaj Thotë:

“E ka arsye t’u bëhet vërejtje vetëm atyre, të cilët kërkojnë leje nga ti, duke qenë të pasur. Ata, kënaqen të shoqërohen me ata që nuk shkojnë në luftë. All-llahu, ua ka vulosur zemrat e tyre, por ata nuk e dinë.” (Et-Teube: 93).

Veç kësaj, myslimanët numerikisht janë shumë më të fuqishëm se hebrenjtë edhe pse hebrenjtë janë më të pasur, ngase hebrenjtë janë gjithsej 20 milionë, ndërsa myslimanët afro 350 milionë, e sikur çdo myslimanë të jpte për Palestinë vetëm nga një grosh - e këtë do të mund ta bënte edhe njeriu më i varfër -, në këtë mënyrë do të tuboheshin tre milion e pesëqind mijë funta. T’i mënjanojmë nëntë të dhjetat e myslimanëve dhe t’ia dedikojmë këtë ndihmë monetare Palestinës vetëm nga një e dhjeta e myslimanëve, përkatësisht prej 35 milionëve, e aspak më tepër! Këta 35 mysliman do t’i gjenim sa çel e mshel sytë rreth vetë Palestinës, ngase myslimanët e Egjiptit, Sirisë, Palestinës, Mesopotamisë, Nexhdit, Hixhazit, Jemenit dhe Ummanit janë 35 milion. Të kërkojmë prej tyre që çdonjëri të japë vetëm nga një grosh. Sa do të tuboheshin me këtë rast? Do të tuboheshin 350 mijë

funta. Së këndëjmi të gjithë myslimanët e përmendur kanë tubuar 13.000 funta, përkatësisht afro një e tridhjeta pjesë e groshit për çdo të dhjetin myslimanë. Vallë, a është kjo ajo që ju e quani sakrificë? Apo vetëm kaq me dëshironi të luftoni në rrugën e Zotit. A vetëm kaq është ndihma e juaj vëllezërve tuaj për nga feja dhe fqinjëve tuaj, të cilët në emër tuaj e mbrojnë Haremin e Shenjtë në Jerusalem, i cili konsiderohet për shenjtëni të tretë në botë dhe është kibla e parë? Jo, thotë Zoti: “Myslimanët janë vetëm vëllezër.” Po, a mos vallë kjo është ndihmë vëllazërore?!”

Përse anglezët kanë pasur sukses të sundojnë me aq zotërrillëk në botë? Kanë sunduar me anë të moralit dhe parimeve. Një njeri i besueshëm më ka rrëfyer se e njeh një anglez me pozitë në Lindje, i cili i urdhëronte shërbëtorit të vet, që nevojat e përditshme jetësore t’i blejë në shitoren e një anglezi, i cili jetonte në atë vend. Një herë, shërbëtori ia paraqet llogarinë mujore me kursim prej 20 funtash, e anglezi e pyet se si ka ardhur deri te kursimi. Shërbëtori i thotë se e ka braktisur shitoren e atij anglezi dhe se kanë filluar të blejë te një tregtar vendas. Në këtë zotëriu i tij i urdhëroi që përsëri të blejë tek ai anglez sikurse edhe përpara, e shërbëtori tha: “A mos vallë edhe nëse kjo kërkon më tepër shpenzim për njëzet funta?” Anglezi tha: “Po, madje edhe nëse kjo kërkon që të shpenzohen 20 funta më tepër.”

Kam dëgjuar se shumë anglez, të cilët jetojnë jashtë, nuk blejnë asgjë me vlerë të madhe pos në atdheun e tyre dhe se i

dërgojnë porositë në Londër për çdo gjë që u nevojitet, në mënyrë që të hollat mos të shkojnë jashtë. A mund ta krahasojmë këtë me veprimin e myslimanëve, të cilët, sado që t'u preferosh të blejnë te bashkëkombësi apo te bashkëqytetari i tyre, nëse ata e dinë se ndonjë mall mund ta blejnë më lirë për gjysmë groshi te evropianët, ata do ta braktisin bashkëkombësin dhe bashkëfetarin e tyre, e do ta zgjedhin evropianin. A nuk janë këto gjëra shkak i mospasqerisë të bojkotit arab ndaj hebrenjve të Palestinës? E kanë privuar veten nga arma më e sukseshme të cilën e kanë pasur në duart e veta - bojkotimin e hebrenjve në shitblerje për shkak të ndryshimit të vogël e të përkohshëm në çmim duke harruar se dëmi i cili do t'i godasë nga kjo shitblerje me hebrenjtë do të jetë njëmijë herë më i madh se ato ndryshime të vogla.

Një herë iu ankova një egjiptiani të shquar për atë se vëllezërit egjiptianë i kanë lënë pas dore luftëtarët e Tripolisit dhe Barkës, të cilëve, edhe nëse nuk do të ishin të obliguar t'u ndihmojnë duke kryer obligimin e vet vëllazëror islamik dhe fqinjësor, atëherë do të duhej ta bëjnë këtë bile nga kujdesi për pavarësinë dhe ardhmërinë e Egjiptit, sepse sado që ekzistenca e Anglezëve në Sudan paraqet rrezik të përhershëm për Egjipt, gjithashtu edhe qëndrimi italianëve në Barkë paraqet rrezik të përhershëm për Egjiptin. Në këtë zotëriu im më është përgjigjur: "Egjiptianët kanë sakrifikuar shuma tejet të mëdha atëherë kur italianët e sulmuan Tripolisin, e nuk arritën asgjë, sepse Italia së shpejti e okupoj atë." Unë ia ktheva: "Vërtetë,

egjiptianët në luftën tripolitanike kanë pasur asi qëndrimi, saqë kjo padyshim e kënaqë çdo mysliman, madje e kënaqë edhe çdo njeri që din të çmon patriotizmin, porse shuma, të cilën e dhuruan atëbotë është e njohur,. e kjo është 150 mijë funta sterlinë. E, a mos vallë, myslimanët e tërë botës dëshirojnë ta shpëtojnë Tripolisin nga kthetrat e Italisë me 150 mijë funta sterlinë? A mundet kjo sakrificë në ndonjë mënyrë të matet me sakrificat të cilat i kanë bërë italianët në të holla dhe në njerëz? Ndihma e Egjiptit për Tripolisin ka qenë 150 mijë funta, ndërsa shteti osmanë në atë luftë i ka shpenzuar një milion funta dhe ja rezultati i kësaj:

1. Rezultati i parë, e kjo është gjëja më e rëndësishme, është ai se është ruajtur fama e Islamit. Evropianëve u është bërë me dije se Islami nuk ka vdekur dhe se myslimanët nuk e japin atdheun e vet pa luftë, e prej kësaj ka dobi materiale dhe morale, të cilën mund ta mohojë vetëm injoranti.

2. Kjo shumë të hollash kundruall shpenzimeve të superfuqive është shkak që i ka nxitur edhe vetë tripolitanët që të bëjnë rezistencë dhe të luftojnë, pasi që kanë parë se janë duke u ndihmuar vëllezërit e tyre, e kjo rezistencë i ka shkaktuar Italisë, e cila i kishte sulmuar, humbje dhe vështirësi të hatashme, andaj shumë politikanë italian flisnin haptazi se janë penduar shumë që e kanë filluar fare këtë sulm kusarësh në Tripoli.

3. Sado i madh që të jetë numri i të vrarëve arabë në këtë luftë, numri i përgjithshëm i italianëve, që janë vrarë gjer më

sot, e tejkalon disa herë numrin e arabëve të vrarë. Italianët në këtë luftë kanë përjetuar aq shumë tmerre, saqë kjo nuk mund të përshkruhet në një artikull apo në një broshurë. Vetëm në një përleshje tek Fuvejhati, në hyrje të Bengazit, ushtrisë italiane që numëronte 3.000 luftëtarë u janë kundërvuar 150 luftëtarë arab, gjersa nuk janë vrarë të gjithë pos disave, të cilët i ka zënë nata, e armiku është zmbarsur. Derisa arabët ishin të pikëlluar për ata që kishin rënë në këtë përleshje, u arrinë lajmi telegrafik nga Stambolli, në bazë të telegramit i cili kishte arritur fshehurazi nga Berlini, e në bazë të telegramit të shifruar që kishte arritur nga legata gjermane në Romë, se në këtë përleshje janë vrarë 1.500 ushtarë italianë dhe se janë çmendur shtatë oficerë. Kjo është një nga së paku 50 përleshje të ngjashme me këtë. Pra, myslimanët në këtë përleshje kanë luftuar me një ushtri 20 herë më të fuqishme dhe i kanë vrarë gjysmën, përkatësisht, kanë vrarë 10 fishë më shumë se numri i tyre - e Zoti i Lartmadhërishëm u ka caktuar myslimanëve që, në gjendje force dhe fuqie, mund ta ngadhënjejnë armikun numerikisht 10 herë më të madh, ndërsa në gjendje dobësie dy herë më të madhe, siç thotë në suren **El-Enfal**, ajeti 65 dhe 66:

“O Pejgamber! Inkurajoi besimtarët në luftë. Nëse në mesin tuaj gjenden njëzet të durueshëm, do t’i mundin dyqind, e nëse nga ju janë njëqind të durueshëm, do t’i mundin njëmijë mohues, sepse, ata janë njerëz që nuk kuptojnë. “Tani, All-llahu u ka lehtësuar juve; Ai di se jeni të lodhur: nëse prej jush njëqind janë të durueshëm do t’i

mundin dyqind; e nëse ju jeni njëmijë - me vullnetin e All-llahut do t'i mundni dy mijë. Se, All-llahu, është me të durueshmit."

4. Shpenzimet italiane, që në vitin e parë, përkatësisht prej 1911 deri 1912, kapnin shumë rreth 100 milionë funta sterlinë, e supozohet se gjer më sot, pas 20 vjetëve - ngase rezistenca nuk ka pushuar gjer në këtë çast - kjo shumë përfshinë rreth 300 milionë funta sterlinë.

Ja, e tërë kjo ka qenë rezultat i asaj ndihme të vogël dhe i shpenzimeve të parandësishme që kanë bërë myslimanët në këtë luftë, mirëpo myslimanët presin që superfuqia siç është Italia, e cila numëron 41 milionë banorë dhe të ardhurat vjetore të cilës janë 200 funta sterlinë, të jetë e ngadhënjyer në një përleshje apo në vitin e parë të luftës, dhe nëse parashikimi nuk realizohet, atëherë ata humbasin çdo shpresë, dështon çdo lëvizje dhe disa i kaplon pikëllimi aq i madh, saqë kjo është e barabartë me mosbesim, sipas fjalëve të Kur'anit:

"Vetëm jobesimtarët e humbin shpresën në mëshirën e All-llahut". (Jusuf: 87).

Ta parashitjet edhe shembullin e tretë, e t'i lamë më shembujt, ngase ata janë të shumënumërt.

Rifanët kanë ngulmuar kundër Spanjës disa vjet radhazi, gjersa nuk e kanë ngadhënjyer dhe ia ka përzënë ushtrinë, pasi që në një përleshje i kanë shkatërruar 26 mijë ushtarë dhe i kanë zënë 170 topa. Rifanët janë gjithsej 800 frymë, ndërsa spanjollë 22 milionë. Toka e Rifanëve kryesisht është

jopjellore, ndërsa banorët janë të varfër, jetojnë nga fitimi i vet. Megjithatë, kanë realizuar një vepër e cila e ka habitur tërë botën. Sikur rifanët të ishin të krishterë, do t'u arrinin me miliona funta sterlinë nga të gjithë, përmes rrugëve sekrete apo përmes kryqit të Kuq, për shërimin e të plagosurve. E, le të na thonë myslimanët sa funta sterlinë u kanë ofruar atëbotë rifanëve?

Pastaj janë bashkuar francezët dhe spanjollët dhe i kanë mobilizuar së bashku me rifanët 300 mijë luftëtarë dhe e kanë bllokuar Rifin nga të gjitha anët, edhe nga toka edhe nga deti, ndërsa aeroplanët e tyre, të cilët hidhnin dinamita në fshatrat rifane, numëroheshin me qinda, e jo me dhjeta. Për më tepër, nuk kanë mjaftuar vetëm aeroplanët e Francës dhe Spanjës, por u kishte ardhur në ndihmë edhe një eskadër aeroplanësh amerikan nga Nju-Jorku (që t'i ndihmojnë këto shtete krishtere kundër myslimanëve vetëm pse janë myslimanë).

Gjersa ndodhte kjo, myslimanët shikonin luftën rifane me duar kryq dhe kështu qëndruan një vit të tërë. Më në fund disa veta u ngritën që të mbledhin diç për luftëtarët e Rifit. Shkrimtari i këtyre rreshtave nuk është kufizuar vetëm të shkruaj përkitazi me këtë çështje, por, me qëllim që të japë shembull, i ka dhuruar katër funta sterlinë. E, sa ka qenë vlera e të gjitha kontributeve nga e tërë bota islame? Ka qenë 1.500 funta!

Ku të ishte fati që myslimanët të mbeteshin vetëm në atë që nuk u erdhën në ndihmë rifanëve, por disa nga mesi i tyre u

ngritën kundër rifanëve dhe luftuan kundër tyre më ashpër se vetë të huajt. Kundër Muhammed b. Abdul-Kerimit u bashkuar shumë fise luftarakisht të disponuara dhe u ndihmuan francezëve dhe spanjollëve kundër bashkëfetarëve dhe bashkëkombëtarëve të vet, vetëm për të fituar simpatitë dhe dashamirësinë e tyre. Njësoj ka ndodhur edhe tek ne në Siri gjatë kohës së kryengritjes kundër Francës, e kjo ka ndodhur edhe në shumë vende të tjera islame. Vallë, e me kësi lloj veprash miku ynë Shejh Bisjuni Imran të kërkojë nga Zoti ta plotësojë premtimin e Vet, përkatësisht t'i jap nam myslimanëve?!

Kur t'i pyesish myslimanët, të cilët e ndihmojnë armikun kundër vëllezërve të vet: “Përse e bëni këtë, pasi që e dini se kjo është në kundërshti me fenë, nderin, kalorësinë, njerëzinë, interesat dhe politikën tonë?”, ata përgjigjen: “si të mos veprojmë kështu kur ata të huaj na ftuan, e ne ishim të detyruar të luftojmë në radhët e tyre nga frika?” Kështu pra, ata i kanë harruar fjalët e lartësuar të Zoti të Madhëruar:

Vallë, a ju frikësoheni atyre? Më e drejtë është t'i frikësoheni All-llahut, nëse jeni besimtarë. (Et-Teube: 13).

Dhe fjalët:

“Ju mos iu frikësoni atyre! Por frikësohuni prej Meje, nëse jeni besimtarë!” (Ali Imran: 174).

Arsyetimet e njerëzve të tillë nuk janë të pranueshme, sepse të huajt i kanë ftuar shumë myslimanë në kësi tradhtish e ata nuk u janë përgjigjur dhe qielli nuk është rrëzuar mbi ta e as

që toka është gremisur nën ta. Nëse këta të huaj, që i kanë okupuar vendet myslimane, janë të hidhëruar në ata myslimanë që nuk i janë përgjigjur thirrjes së tyre për ta tradhtuar popullin e vet, kjo ngjanë për shkak se shumë myslimanë u kanë ofruar shërbimet e veta kundër vëllezërve të vet dhe këto shërbime i kryenin me vullnet të madh dhe me sinqeritet të plotë, duke shfaqur kështu besnikërinë e plotë gjatë kohës së këtyre veprave tradhtare. Sikur të mos ekzistonte kjo tradhti vullnetare dhe ky nxitim që të ndihmohet i huaji kundër bashkëfetarëve të vet, atëherë i huaji nuk do të konsiderohej si luan, dhe nuk do të sillej kështu në mënyrë arbitrare me myslimanët dhe nuk do të kërkonte prej tyre që të punojnë kundër dispozitave fetare dhe kundër interesave personale në favor të interesave të tyre, madje edhe nëse do t'i ndjeknin gjer në vdekje.

Ekzistojnë dy lloj vdekjesh. E para është vdekja për shkak të jetës, e kjo është ajo vdekje për të cilën Kur'ani i inkurajon myslimanët kur armiku i sulmon ata, dhe kjo është ajo vdekje për të cilën poeti arab thotë: “U zmbarsa duke u përpjekur që të mbahem në jetë, por nuk gjeta jetë më të bukur se sulmi.” Kjo është ajo vdekje, me të cilën vdes francezi për jetën e Francës, gjermani për jetën e Gjermanisë, anglezi për jetën e Britanisë së Madhe etj., duke konsideruar këtë si obligim të vetin, nga i cili kurrënjëherë nuk do të shmanget.

Lloji i dytë është vdekja për shkak të vazhdimit të vdekjes, e kjo është vdekje me të cilën vdesin myslimanët në shërbimin e atyre shteteve të cilët i kanë okupuar viset e tyre. Kjo ndodhë

kështu për shkak se ata vdesin duke u ndihmuar okupuesve kundër armiqëve të tyre, siç vdes për shembull afrikani verior që të fitojë Franca kundër Gjermanisë, apo kur vdes hindusi që Britania e Madhe ta mund kundërshtarin e vet, apo siç vdes tatari për fitoren e Rusisë. Mirëpo, Franca, me mundjen e armiqve të vet, e rritë krenarinë dhe autokracinë e vetë, i rrëmben vendet në Afrikën Veriore dhe i shkelë të drejtat e tyre, siç ka ndodhur pas Luftës Botërore kur francezëve iu rritën aspiratat për Marokon dhe iu zgjua dëshira për krishterizimin e berberëve.

Thënë shkurtimisht, afrikani verior vdes në brigjet e Rajnës apo në Siri, në mënyrë që ta rritë vdekjen në Afrikën Veriore, ngase çdo fitore e Francës jasht, paraqet rritjen e shtypjes, dhunës dhe poshtërimit në Afrikën Veriore, për të cilën ekziston ilaç. Kjo është vërtetuar me anë të eksperiencës.

Po ashtu, vdekja e një hindusi për fitoren e Anglezëve paraqet vazhdimin e afatit të robërisë së Indisë. Gjithashtu, vdekja e një tatari në shërbimin e Rusisë nuk ka rezultat tjetër pos rritjen e shtypjes së Rusisë ndaj tatarëve, e kështu me radhë.

Kjo vdekje për shkak të vetë vdekjes, është, siç thuhet, vdekje në vijë të shtrembër, përkatësisht duke marrë parasysh rezultatit përfundimtar, e këtu ekziston edhe vdekja e drejtpërdrejt për shkak të vetë vdekjes, atëherë kur afrikani verior vdes në luftë kundër vëllait të vet, i cili ngritet për ta zvogëluar shtypjen e zgjedhës franceze, e cila gati sa nuk ua ka

thërrmuar qafën, apo nëse nuk ua ka thërrmuar tërësisht, atëherë ua ka lënë jetën e cila tërësisht i gjason vdekjes.

Sikurse këto raste të ishin kufizuar vetëm tek masa e gjerë dhe tek të paudhëzuarit, ne do t'ua falnim për shkak të paudhëzimit të tyre dhe to të thoshim se ata nuk dinë as për Kur'an as për Sunnet, nuk e njohin as politikën botërore as rrethanat bashkëkohore. Mirëpo, ajo që është më e mjerueshme është tradhtia e liderëve, siç është ministri Makkar, i cili është më i flaktë sesa vetë francezët për aksionin e abrogimin (anulimin) e Sheriatit të berberët. I tillë është edhe Bagdadi, mëkëmbës i Fezit, i cili i ka rrëzuar 100 të rinj të Fezit dhe i ka shkopitur vetëm pse janë tubuar në xhaminë e Karvanit për t'u lutur: "O Mëshirues, ke mëshirë për fajin tonë dhe mos na ndajë nga vëllezërit tanë berberët!" I tillë është edhe myftiu i Fezit, i cili ka dhënë fetvanë se abrogimi i sheriatit mes berberëve nuk do të thotë se berberët dalin nga Islami, etj. Çdonjëri prej këtyre tradhtarëve, të cilët kanë dalur nga feja - Zoti i poshtëroftë! - tanimë ka përjetuar pleqërinë e thellë dhe është ngirë me pasurinë e popullit, e nga ana tjetër çdonjëri e dëshiron me gjithë shpirt simpatinë e Francës dhe orvatet ta dëshmojë sinqeritetin e vet ndaj saj, madje edhe me kusht që ta humbas fenë e vet dhe pasurinë e vet, vetëm për ta ruajtur pozitën dhe rrogën e vet gjatë kësaj pak jete të shkret sa i ka mbetur gjer në vdekje.

asnjë rast kur evropianët i kanë pushtuar shtetet islame e që gjysma e tyre, apo së paku një pjesë e tyre, të mos jetë i realizuar me ndihmën e myslimanëve. Disa bëjnë spiunim kundër popullit të vet në favor të të huajve, disa përhapin propagandat e tyre tek populli i vet, e disa luftojnë me shpatë lakuriq dhe në shërbim të të huajve derdhin gjakun e popullit të vet. Prandaj, islami i tyre dhe besimi i tyre është shumë larg fjalëve të Zotit të Lartmadhërishëm:

“Kushdo që prej jush i konsideron ata për miq, ai është me ta. (El-Maide: 52).

Dhe fjalët:

“All-llahu u ndalon juve t’i bëni miq ata që luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe ju dëbojnë nga vatrat tuaja, si dhe kontribuojnë që të jeni të dëbuar; e kushdo që i bën miq ata, - të tillët janë zullumqarë.” (El-Mumtehine: 9).

A mos vallë, në këtë mënyrë i nënshtrohem i Zotit dhe Pejgamberit të Tij?! A mos vallë, në këtë mënyrë bëhet vëllazërimi dhe miqësia islame?! A mos vallë, njerëzve të tillë Zoti u ka premtuar autoritet, ndihmë dhe mirëqenie në tokë, duke qenë se ata për interesa të armikut i spiunojnë bashkëfetarët e vet, atdheun e vet dhe popullin e vet?! Kurdoherë që t’i qortojmë për tradhti, ata arsyetohen se nuk mund të rezistojnë, se në këtë mënyrë shpëtojnë nga dhuna e të huajve ose që prej dy të këqijave zgjedhin atë më të voglën. Të gjitha këto arsyetime të tyre nuk përmbajnë në vetë as një thërmijëz nga e vërteta. Ata me siguri kanë mundur që me

shpat ta ndihmojnë popullin e vet, e nëse megjithatë këtë nuk kanë mundur ta bëjnë, atëherë kanë mundur me pendë, e nëse edhe kështu kanë mundur, kanë mundur me fjalë, e nëse nuk kanë qenë në gjendje të veprojnë kështu, atëherë së paku kanë mundur me zemër. Ndërkaq ata vetëm dëshirojnë që të jenë miq intim të të huajve kundër popullit të vet, të jenë kuadrot e tyre udhëheqëse kundër shtetit të vet dhe urë e të huajve kundër atdheut të vet, andaj përkundër të gjitha këtyre i sheh ata se si jetojnë në begati, disponim, kënaqësi, flejnë të qetë dhe hajnë atë që kanë fituar për kujdesjen e myslimanëve dhe për gjakun e derdhur të myslimanëve. Këta njerëz nuk posedojnë aspak ndërgjegje, që t'i brenë nga brenda, ndërsa prej myslimanëve nuk ekziston asnjëri që do t'i mendojë nga jashtë.

Këtë nuk konfirmojmë përgjithësisht për botën islame, ngase për shembull populli afgan nuk i lejon askujt që t'i ndihmojë haptazi të huajt e të mbetet gjallë. Ndër banorët e Nexhdid nuk mund të gjendet askush që u ndihmon të huajve kundër popullit të vet. Arsimimi politik i egjiptianëve ka përparuar shumë në krahasim me gjendjen e përparshme, andaj është bërë gjë e rrezikshme të shfaqet publikisht simpatia ndaj të huajve apo t'i ipet përparësi regjimit të tyre. Për sa i përket vendeve të tjera islame, çdo mysliman mundet haptazi të angazhohet për armiq të fesë së vet dhe të atdheut të vet, e të mos ketë frikë se do t'i ndodhë ndonjë e keqe.

Për njerëzit e këtillë Zoti i Lartmadhërisëm thotë:

“All-ahu u ka premtuar disave prej jush, që kanë besuar dhe që punojnë vepra të mira - se do t'i bëjë sundimtarë në Tokë, ashtu, si i ka bërë ata para tyre dhe që do t'ua forcojë fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur, dhe që do t'ua shndërrojë atyre - pas frikës, sigurinë. Ata, më adhurojnë Mua, e nuk më bëjnë shok asgjë. E, kush bënë mohim pas kësaj, ata janë ngatërrestarë të vërtetë.” (En-Nur: 55).

Me këto fjalë Zoti i Lartmadhërishëm nuk aludon në myslimanët të cilët e tradhtojnë popullin e vet, punojnë për armiq të tij dhe shprehin armiqësi ndaj vëllezërve të vet duke tentuar të nxisin kënaqësinë e të huajve e të prokurojnë pasuri afatshkurtër. Si do të mund të jetë fjala për ta pasi që, krahas besimit është ndërlidhur ajo që është e pandashme nga ai - e këto janë veprat e mira? Sa e shëmtuar është ajo për çka i kanë shitur ata shpirtërat e tyre! Gjithashtu Zoti xh.sh. nuk aludon as në ata myslimanë, të cilët, edhe pse me zemër nuk janë kundër popullit të vet dhe nuk kanë punuar për të huajt e as që i kanë kërrusur supet e veta që në to të hipin të huajt lakmitarë, por megjithatë janë të kënaqur me atë që të përkulen, të bien në gjunj, të luten, të përmendin Zotin, të bëjnë tesbih dhe të qëndrojnë gjatë në sexhde, duke konsideruar se ky është Islami i vërtetë. Sikur kjo të ishte e mjaftueshme që njeriu të bëhet myslimanë dhe të arrijë shpëtim edhe në këtë botë edhe në botën tjetër, atëherë Kur'ani nuk do të ishte përplotë me nxitje në xhihad, vetëmohim, singëritet, durim, të ndihmuarit reciprok të vëllezërve myslimanë, drejtësi, bamirësi dhe me të gjitha

bujaritë e mundshme. Sikur të ishte kjo e mjaftueshme që me të vërtetë të jetë dikush myslimanë, atëherë Zoti i Lartmadhërishëm nuk do të thoshte:

“Thuaj: “Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj, që e keni fituar, tregtia - për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë - dhe shtëpitë në të cilat e ndieni veten rehat, u janë më të dashura se All-llahu, se i Dërguari i Tij dhe se lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni derisa ta sjellë vendimin All-llahu. E, All-llahu nuk don ta udhëzojë në rrugën e drejtë popullin e korruptuar.”
(Et-Teube: 24)

A mundet miku ynë Shejh Bisjuni Imran, apo kushdo qoftë tjetër, të konfirmojë se myslimanët e sotëm, përveç një pakice të vogël dhe gati mosekzistuese, i japin përparësi Zotit dhe Pejgamberit të Tij kur është fjala për prindërit e tyre, fëmijët, vëllezërit, bashkëshortet, tregtinë, pasurinë dhe banesat?! A i japin myslimanët e sotëm përparësi dashurisë ndaj Zotit dhe Pejgamberit të Tij - e kjo dashuri është e vetmja për mbajtjen e Islamit - kundruall pjesës të parëndësishme të pasurisë së tyre që e fitojnë në tregti, nga dështimi i së cilës kanë drojë prore?!

Ta bëjmë një provë, ngase gjërat kristalizohen vetëm me kontrastet e tyre.

Të pandehim se çështja e krishterizimit të berberëve është pjekur dhe papa i thërret të gjithë katolikët të sakrifikojnë para të duhura për këtë transformim nga islamizmi në krishterim, rreth së cilës Franca bënë përpjekje përkitazi me berberët. Çka

mendon, sa miliona funta sterlinë do t'u arrinin misionarëve, murgjve dhe murgeshave për ndërtimin e kishave, shkollave, azileve, spitaleve, qendrave episkopale e të ngjashme, në mënyrë që të kjo punë të kryhet me sukses e cila katolicizmit do t'i sillte tetë milionë berberë krahas 400 milionëve katolikë që ekzistojnë në botë? Padyshim, përgjigjja do të ishte kjo: brenda disa muajve do të tuboheshin shumë milionë funta sterlinë.

E nëse do t'u thuhej protestantëve: “Ejani, ju kemi lejuar që t'i krishterizoni berberët, andaj sakrifikoni për këtë sa të mundeni.” Atëherë atyre do t'u arrinin dyfish më tepër miliona sesa katolikëve, dhe atë për një kohë edhe më të shkurtër. E t'u themi myslimanëve: Berberët gati sa nuk e kanë braktisur Islamin. Shkaku kryesor për këtë është padituria. Andaj jemi të obliguar t'i dërgojmë njerëzit e dijshtëm dhe vaizët për t'i udhëzuar në fe, është nevoja t'u ndërtojmë xhami, shkolla të mesme dhe të ulëta, strehimore dhe për mjete të tjera, të cilat do t'i lidhnin për Islamin dhe myslimanët.” Çka mendoni, pas të gjitha këtyre, sa do të sakrifikonin myslimanët për një vepër të tillë? Unë mendoj se nuk do të jipnin më tepër se një të njëqindtën pjesë nga ajo që do të jipnin katolikët apo protestanët.

Ja se çfarë interesimi për fe mbretëron tek të krishterët, e çfarë tek myslimanët, mirëpo përsëri disa pyesin se cili është shkaku i rënies së myslimanëve dhe i prapambeturisë së tyre në

garim me të tjerët, e sikur të përsiatnin për këto dallime në punë dhe entuziazmin për përparim, do ta gjenin përgjigjen.

Gjëja më e çuditshme është se, pas të gjitha këtyre, përsëri shohim se evropianët, propagatorët e tyre dhe nxënësit e tyre lindor i akuzojnë myslimanët për fanatizmin fetar dhe i quajnë ata fanatikë, ndërsa vetes ia prokurojnë tolerancën fetare. Për Zotit, me të vërtetë kjo është çudi mbi çudira! Ja, unë në këtë vepër, domethënia e së cilës është mbrojtja e jo sulmi, dijetari i madh pronari i “El-Mena-rit” Abdul Hamid bej Saidi, kryetari i shoqatës “Rinia myslimane”, dijetari dhe pronari i “El-Fet’h-it” e të tjerët, të cilët dëshirojnë ta pengojnë sulmin në Islam dhe t’i thërrasin myslimanët që të këndellen dhe ta shohin rrezikun që i ka mbërthyer, jemi të akuzuar për fanatizëm fetar dhe të quajtur me këtë emër jo vetëm mes myslimanëve, por edhe mes myslimanëve gjeografik, përkatësisht mes atyre që mburren se politika e tyre është laike, të cilët që moti janë deklaruar se aspak nuk i japin rëndësi fesë dhe të cilët që moti i bëjnë lajka të krishterëve duke deklaruar se nuk janë duke mbrojtur Islamin në mënyrë çfarë e bënë dikush.

Myslimani mund të shpëtoj nga emri “fanatik” vetëm nëse bëhet i pashkathët kur dëgjon për fushatën franceze për t’i krishterizuar berberët dhe kur dëgjojnë se holandezët i kanë krishterizuar 100 mijë myslimanë - një deputet i parlamentit holandez ka konfirmuar se u kishte shkuar për dore që në Javë t’i krishterizojnë një milion myslimanë - nëse i rrudhë krahët e thotë: “Mua nuk më intereson se a është myslimanë një javas

apo jo.” Vetëm atëherë myslimani do të jetë përparimtar e të konsiderohet si bashkëkohor dhe për të do të flitet çdo e mirë. Përkundrazi, evropiani mund të jap shuma të mëdha të hollash për zgjerimin e propagandës krishtere ndër myslimanët, këtë propagandë mund ta mbrojë edhe me topa, me aeroplanë dhe me tanksa, mund t’i pengojë myslimanët në fe, drejtpërdrejt apo tërthorazi, mund të përdorë të gjitha marifetllëqet e mundshme për ta rrëzuar Islamin në vendet islame, e megjithatë të mos i shkruhet kjo si mëkat, dhe kjo punë të mos ia merr epitetin e përparimtarit, të kulturuarit dhe bashkëkohësit, e, që është edhe më e çuditshme, kjo nuk ia merr atributin e qytetërimit, “laikut” dhe “tolerantit”.

Myslimanët e tillë “gjeografik, përkundër këtyre argumenteve të qarta, përkundër asaj që ka bërë republika laike franceze për interesat e kishës katolike përkitazi me çështjen e berberëve; përkundër mbrojtjes holandeze ndaj propagatorëve të Ungjillit (Evangjeljes) në Javë; përkundër vendimit zyrtar të qeverisë belge që të përfundojë krishterizimi i banorëve të Kongos; përkundër propagandës islamike holandeze në Ugandë dhe Daru’s-Selam (Zizibar), e gjithashtu edhe në Sudan ndër zezakët nga ana e Anglisë, dhe përkundër shumë gjërave, të cilat tani nuk mund t’i parashtrojmë, këta myslimanë gjithnjë i mashtrojnë myslimanët duke thënë: “Evropa e ka shtyer me këmbë fenë dhe ka marrë drejtim laik, andaj edhe ka arritur sukses. As ne kurrë nuk do të kemi sukses përderisa i mbahemi drejtimit fetar.” Këtë sofizëm disa njerëz e kanë përhapur në

Turqi ku kanë gjetur një numër të madh ithtarësh. Disa prej tyre i shohim edhe në Egjipt, Siri, Mesopotami dhe Persi, të cilët i pasojnë këta sofistë dhe në mënyrë cinike i urrejnë faktet pa kurrfarë marje, sepse, para së gjithash gjejnë njerëz naivë të cilët u besojnë.

Shkaqet kryesore të prapambetures së myslimanëve

Shkaku më i madh i prapambetjes së myslimanëve është padituria, për shkak të së cilës ndërmjet tyre ekzistojnë edhe të tillë që nuk dinë ta dallojnë verën nga uthulla, andaj sofizmin e konsiderojnë si aksiomë e cila nuk mund të ngadhënjehet.

Dituria e mangët gjithashtu është një nga shkaqet më të mëdha të dekadencës myslimane. Kjo është më e rrezikshme se vetë padituria e thjeshtë, sepse kur i padituri hasë në udhëheqësin e ditur, ai do ta dëgjojë këtë, e nuk do të filozofon me të, kurse ai që ka arsimim të mangët nuk din dhe nuk mund të bindet që nuk din. Një fjalë e urtë thotë: “Më mirë e ke të kesh punë me një budalla të plotë se me gjysmë budalle”. E unë them se më mirë është të kihet punë me njeriun e paditur sesa me gjysëm të arsimuarin.

Prej shkaqeve më të mëdha të dekadencës myslimane është edhe çoroditja morale, për shkak të mungesës të atyre virtyeteve, në të cilat nxitë Kur’ani, dhe iniciativës, e cila i ka stolitur myslimanët e parë dhe me të cilën ata kanë korrur sukses,

ndërsa morali është përmbi arsimin për formimin e popullit. Sa bukur ka thënë Shevkiu: “Popullin e formon vetëm morali, gjersa ekziston; po që se zhduket morali, zhduket edhe populli.”

Njëri nga faktorët më të mëdhenj të prapambeturisë së myslimanëve është para së gjithash çoroditja morale e udhëheqësve të tyre, të cilët mendojnë se - përveç disave që i ka mëshiruar Zoti - populli është krijuar për ta dhe se mund të bëjnë me të çka të donë. Ky mendim tek ata është aq thellë i rrënjësuar saqë në mënyrë të përmbaruar ndëshkojnë secilin që ndërmerret diç për t'i kthyer në rrugë të drejtë. Madje edhe disa dijetarë i bëjnë lajka këtyre udhëheqësve duke u krekosur në mirëqenien e tyre dhe duke ua lëpirë njejtë japin fetva se është e lejueshme që të mbytet çdo këshilltar që nuk është i dëgjueshëm dhe që del nga bashkia.

Islami i porositetë imamët që t'u përmirësojnë udhëheqësve ekstravagancën (të çoroditurit) e tyre dhe ata në shtetet ideale islame kanë qenë sikurse parlamenti i sotëm: kontrollojnë popullin e njëkohësisht rregullonin drejtimin e sundimitarit, ngritnin zërin e vet kur pushteti binte në lajthitje dhe i thërrisnin sundimtarët dhe nënrenditësit e tyre në rrugë të drejtë. Kështu gjërat shkonin në rregull, ngase shumica prej këtyre imamëve ishin tejet të devotshëm andaj nuk ngarendnin për kënaqësitë e kësaj bote dhe nuk kishin kurrfarë konsiderate se a do të hidhërohet ndonjë sundimtarë apo jo. Andaj sundimtarët dhe kalifët ua kishin frikën dhe nuk guxonin t'i

kundërshtonin, ngase e dinin se masa e gjerë e popullit u besonin atyre. Mirëpo, gjatë kohës këta imam i kanë trashëguar trashëgimtarët e padenjë, të cilët shkencën e kanë shndërruar në profesion për ekzistencë e fenë kurthë për pasuri, andaj u lejonin udhëheqësve të prishur poshtërsi më të shëmtuara dhe në emër të fesë u lejonin t'i shkelin dispozitat e fesë. Kështu vepronin ata, ndërsa masa e ndjerë ishte mashtruar me madhësinë e turbanëve dhe pozitive të larta të këtyre imamëve duke menduar se fetvatë e tyre janë korrekte dhe se mendimet e tyre janë në përputhshmëri me shariat. Në këtë mënyrë të prishurit rritej gjithnjë e më tepër, interesat e popullit rrënoheshin, Islami binte në dekadencë ndërsa armiku ngritej dhe forcohej. Për të gjitha këto gjëra përgjegjësinë e mbajnë imamët.

Ndër faktorët më të mëdhenj të prapambeturisë së myslimanëve bën pjesë edhe frika dhe ligështia, të cilat shfaqen tek ata pasi që ishin populli më i njohur për nga trimëria dhe përbuzjes (mospërfilljes) së vdekjes, atëherë kur vetëm njëri u kundërvijet dhjetë vetëve, e ngandonjëherë edhe njëqind vetëve. Mirëpo sot janë bërë, përveç disave, të atillë që ia kanë frikën vdekjes, e kjo frikë dhe Islami nuk mund të bashkohen në një zemër. Është për t'u çuditur se agresorët evropian duke i sulmuar myslimanët nuk kanë frikë nga vdekja aq sa frikësohen myslimanët duke u mbrojtur. Myslimanët edhe pse i shohin ato caqe të largëta të cilat evropianët i arrijnë duke përçmuar jetën dhe duke u hudhur në rreziqe për popullin dhe atdheun e tyre,

megjithatë aspak nuk i kaplon zilia dhe nuk duan të thonë se ata janë më të denjë për t'a përçmuar jetën sesa evropianët pasi që Zoti i Lartmadhërishëm thotë:

“Mos u tregoni të dobët në ndjekjen e armiqve (për të luftuar kundër tyre). E, nëse ju ndieni dhembje prej luftës, edhe ata ndiejnë dhembje ashtu si ndieni edhe ju. Mirëpo, ju shpresoni prej All-llahut atë që nuk e shpresojnë ata.”
(En-Nisa: 104)

Frikës dhe ligështisë që i ka goditur myslimanët, u janë shoqëruar edhe pikëllimi dhe pashpresa në mëshirën e Zotit, andaj disa myslimanëve u është rrënjësuar në kokë se evropianët janë gjithsesi ngadhënjimtarë, se nuk ekziston kurrnjë mënyrë të luftohet me ta, se çdo rezistencë kundër tyre është e kotë dhe se çdo veprim është marrëzi. Kjo frikë nga evropianët është rritur dhe fermentuar në zemrat e myslimanëve, kështu evropianët janë të ndihmuar edhe me këtë frikë, andaj edhe një numër i vogël i tyre mund t'u bëjë ballë numrit më të madh të myslimanëve, në të kundërtën e asaj që ka qenë në kohën e Islamit. Në një verset thuhet: “Frikacakët konsiderojnë se frika është kujdesi, e kjo është mashtrim i natyrës së prishur”.

Myslimanët kanë harruar të kaluarën, kur vetëm njëzet myslimanë kishin vajtur në brigjet franceze dhe aty ishin vendosur në një kodër, ku ndërtuan një kështjellë. Numri rritej gjithnjë gjersa nuk arriti një mijë njerëz. Ata aty formuan një principatë e cila fitoi renome të madhe në Francën Jugore dhe Italinë Veriore, miqësinë e të cilës kërkonin sundimtarët e atyre

viseve me të cilët arritën marrëveshje paqe. Kjo përfshinte majat e Alpeve dhe kalimet e rrugëve kryesore ndërmjet Francës dhe Italisë, andaj të gjithë karvanët evropianë gjatë kalimit nëpër këto rrugë ishin të obliguar t'u paguajnë arabëve doganën e caktuar. Ky shtet i vogël arab përparonte në Pijemont, gjersa nuk u zgjerua gjër tek Zvicra dhe liqeni Konstancë në zemrën e Evropës, duke i bashkangjitur vetes një pjesë të madhe të Zvicrës. Në këto treva ata sunduan nëntëdhjetë e pesë vjet (prej vitit 888), derisa popujt evropian nuk u bashkuan kundër tyre dhe luftuan me ta përderisa nuk i shkatërruan. Ky grusht i vogël arabësh, edhe atëherë kur u shkatërrua, nuk numëronte më tepër se një mijë e pesëqind njerëz.

Është i marrë çdo njëri që do të thoshte: Po, kjo ka ndodhur para se që evropianët kanë zbuluar mjete të reja lufte, para topave, tanksave, aeroplanëve dhe para se ata të kenë arritur fuqinë që kanë sot, e cila bazohet në shkencë. - Këto fjalë janë marrëzira të pastra, mendjelehtësi dhe budallallëk, ngase çdo kohë posedon shkencën përkatëse, ashtu siç posedon edhe koha e sotme. Çdo gjë në botë është relative. Edhe në atë kohë ka pasur makina luftarake, gjuajtës të gurëve (katapulta), makina për bllokime dhe ekzistonin materie ndezëse të cilat janë bërë në mënyrë të panjohur për ne. Këto aparate në kohën e vet kanë qenë siç janë sot topat, pushkët automatike, bombat, dinamitët dhe gjëra të ngjashme që ekzistojnë sot. Tekembramja, tanksat, aeroplanët dhe eksplozivët nuk nxisin

trimërinë as që flakërojnë patriotizmin në zemra, porse patriotizmi, nismëria dhe trimëria krijojnë aroplanë, tanksa dhe bomba. Këto janë vetëm lëndë memecë ndërmjet të cilave edhe gurit të rëndomtë nuk ekziston kurrfarë dallimi. Materia vetvetiu nuk mund të krijojë asgjë, porse ai që krijon është intelekti, andaj kur intelekti posedon entuziazëm dhe kur zgjohet vendosmëria, atëherë lehtë gjenden tanksat, aroplanët, pushkët automatike, nëndetëset dhe të gjitha mjetet tjera lufte.

Thuhet se t'i posedosh të gjitha këto është nevoja për shkencë moderne, e cila u mungon myslimanëve, andaj evropianët mund të bëjnë atë që myslimanët nuk mundën. Përgjigjja për këtë është:

Nën një: edhe shkenca moderne varet nga idetë dhe iniciativa; posa të gjenden këto dyja, do të gjendet edhe shkenca moderne dhe zejet moderne.

Është e njohur se japonezët gjer në vitin 1868 kanë qenë të njëjtë sikurse popujt e tjerë lindor në gjendje patrialkale, dhe kur dëshiruan t'i arrijnë popujt modern, i mësuan shkencat evropiane dhe i zënë zejet e tyre, e tërë këtë e arritën për pesëdhjetë vjet. Prandaj, çdo popull islam i cili do të dëshironte t'i mbërrijë e t'i tejkalojë popujt e fuqishëm, do të mund të arrinte këtë, siç i kanë mësuar japonezët dituritë evropiane dhe janë barazuar me ta, kështu që në asgjë nuk janë prapa tyre, e megjithatë kanë mbetur japonez të cilët e çmojnë besimin e vet dhe zakonet e veta.

Nën dy: a ekziston ndonjë popull myslimanë që ka kërkuar vegla dhe armë e të mos i gjejë ato? Gjëja kryesore është vullneti, e kur të gjendet ky edhe caku do të arrihet lehtë. Sikur të donte ndonjë popull mysliman të armatosej, brenda natës do t'i gjente të gjitha llojet e duhura të armëve moderne. Vetëm që për t'u furnizuar me këto armë është nevoja për sakrifikimin e pasurisë, porse ata nuk dëshirojnë ta bëjnë këtë e as që dëshirojnë t'i marrin shembull evropianët dhe japonezët në vetësakrificë, por dëshirojnë fitoren pa armë dhe pajisje apo dëshirojnë armë dhe pajisje pa sakrifikimin e pasurisë. E, kur armiku i ngadhënjen ata, atëherë bërtasin: Ku janë ato premtime që na ka premtuar Kur'ani me fjalët: "Ne jemi të obliguar t'i ndihmojmë besimtarët"?, sikurse Kur'ani t'ua ketë garantuar fitoren myslimanëve pa kurrfarë pune dhe mundi, pa luftë me pasuri dhe jetë, por vetëm për shkak se thonë që janë myslimanë apo vetëm për shkak të vetë lutjes dhe madhërimit të Zotit. Edhe më e çuditshme është se disa dëshirojnë ta arrijnë këtë duke kërkuar ndihmë nga evliatë. Në këtë mënyrë edhe numri më i madh i myslimanëve të paarmatosur me armë moderne dhe të papajisur me dituri të duhur për përdorimin e armëve moderne nuk mund t'i bëjnë ballë as një numri të vogël evropianësh të armatosur e të arsimuar, dhe, kurdoherë që ballafaqoheshin, myslimanët nxjerrin skajin më të hollë. Kështu ka qenë për një kohë të gjatë, gjersa nuk e humbën çdo besim në vete, rënë në pikëllim dhe frika hyri në ta kështu që vetë iu dorëzuan armiqëve. Ja, në këtë mënyrë nga myslimanët

luftarakë u shndërruan në rajë të nënshtruar, ngase harruan fjalët e Zotit të Lartmadhërishëm:

“Mos tregoni ligësi dhe mos u pikëlloni! Se ju gjithsesi jeni më të lartë, nëse jeni besimtarë të vërtetë. Nëse ju ka goditur juve ndonjë plagë edhe popullin (armik) e kanë goditur aso plagë Ne, këto ditë i japim fitore herë njëres herë tjetrës palë...”. (Ali Imran: 139-140).

Ata harrojnë se askush, as nga pikëpamja fetare e as nga ajo logjike, nuk guxon të bjerë në pikëllim, e posaçërisht myslimani, të cilit feja i tregon se pikëllimi është i barabartë me mosbesim. Ata nuk i përfillin fjalët e Zotit të Lartmadhërishëm që i thotë për të parët e tyre:

“Atyre, të cilëve u thanë njerëzit: ”Armiku është përgatitur kundër jush, frikësohuni!”, kjo përkundrazi ua shtoi atyre besimin, e thanë: “Neve na mjafton All-llahu, dhe Ai është mbrojtës i mrekullueshëm! Ata u kthyen (nga Bedri) me dhuntitë dhe begatitë e All-llahut, nuk i gjeti asgjë e keqe...” (Ali Imran: 173-174).

Prandaj, kur i thërret myslimanët që t’u vijnë në ndihmë ndonjë nga popujt myslimanë, të cilët luftojnë kundër ndonjë shteti evropian që dëshirojnë ta shkatërrojnë atë, i pari prej tyre do të thotë: “Çfarë leverdie ka që për këtë qëllim të shpenzohet pasuria më kot, pasi që ajo fuqi gjithsesi do të ngadhënjejë”?! Sikur të mendonin mirë, do të shihnin se dorëzimi të huajve vetëm i zmadhon fatkeqësinë dhe e rritë absolutizmin dhe

despotizmin e armikut. Ky është ligji i Zotit në botë. Sikur të mendonin mirë, do të shihnin se kjo koprraci ndaj vëllezërve të tyre që gjenden në fushë lufte e beteje, nuk paraqet kurrfarë kursimi, por varfërim, ngase populli i rraskapitur do të bëhet i lirë në tregti dhe ekonomi, por ngadhënjyesi i thithë të gjitha langjet e vendit të tij duke u lanë të humburve vetëm eshtërat e brejtur, sa për të mundur të jetojnë. Shpeshherë paraqitet uria dhe ata vdesin nga ajo, siç ndodh shpeshherë në Algjeri, Indi dhe në vende të tjera. Shohim të uriturit në Indi, por nga kjo nuk vdesë kurrnjë anglez, shohim të uriturit në Algjeri, por nga kjo vdesin vetëm myslimanët. Shkaku i vetëm për këtë është ai se të huajt kanë përvetësuar për vete të gjitha pasuritë e vendit duke mos u lënë myslimanëve asgjë përveç varfërisë. Myslimanët sot e arsyetojnë koprracinë e vet me varfëri në ndihmë vëllezërve të tyre. Kjo deri diku është e saktë. Kanë rënë në mjerim, ngase në fillim kanë koprracuar, andaj së pari kanë korrur frytet e poshtërimit dhe nënshtrimit, e pastaj të varfërisë dhe urisë, si pasojë e domosdoshme të koprracisë për luftë. Ligji i Zotit në tokë është që varfëria pason pas poshtërimit, ndërsa pasuria pas namit dhe fuqisë, kurse fjala e urtë arabe thotë: “Kush fiton, ndanë.” Një poet arab, nga fisi Ijad, thotë: “Mos e ruani pasurinë për armikun, sepse, nëse ju ngadhënjëjnë, ata do t’ju marrin edhe ju edhe kursimin tuaj. Kurrfarë fati nuk ka as në pasuri as në mirësi nëse i ruani ato, përderisa iu thehen hundët.” Mutenebbiu thotë: “Nuk është i famshëm në këtë botë ai që është i varfër, kush s’ka famë, ai

s'ka as pasuri.”

Për myslimanët pasuria ka qenë e çmueshme, andaj edhe e kanë humbur atë, ka qenë jeta e çmueshme, andaj e kanë humbur edhe atë, ngase Zoti ka dashur t'i vërtetojë fjalët e të Dërguarit të Tij, të cilat ia ka frymëzuar Vet: *“Së shpejti do t'ju sulmojnë popujt ashtu siç vërsulen të uriturit në çanakë.”* As'habët pyetën: “O Pejgamber i All-llahut, a do të ndodh kjo pasi që do të jemi pak?!” “Jo” - tha ai, *“porse do të jeni sikurse vërshimëza e rrëkesë, do t'ju futet ligështia në zemrat tuaja, kurse do të nxirret nga armiq të tuaj për shkak të dashurisë suaj ndaj pasurisë dhe frikës nga vdekja.”*

Këtë hadith ma ka treguar Shejh Kettani nga Feza - Zoti e mëshiroftë! - atëherë kur u takuam në Medinë para tetëmbëdhjetë vitesh, pastaj e kam lexuar në libra dhe e kam parashtruar si argument në parathënien e veprës “Bota bashkëkohore islame”. Fjalët e këtij hadithi janë të ndryshme në disa transmetime. Dijetari, pronari i “El-Menar-it” - Zoti i dhashtë jetë të gjatë, që bota të ketë dobi prej tij! - më së miri e di se cila traditë është më e saktë, porse domethënia e këtij hadithi është e qartë, e kjo është: Myslimanëve do t'u vijë koha kur do të bëhen pre dhe kur nga të gjitha anët do të zgjaten duart kah ata. Këtë kohë jemi duke përjetuar sot.

Nuk është e metë e myslimanëve se ata janë numerikisht pak. Numri i tyre është shumë i madh, por kjo nuk u bënë dobi, ngase shumësia vetvetiu nuk vlen asgjë, nëse mungon kualiteti i llojit. Kuantiteti nuk mund të zëvendësojë kualitetin. Shkaku

kryesor i dobësisë së myslimanëve janë frika dhe koprracia, që është theksuar në fjalët e Të Dërguarit Të Zotit: *“për shkak të dashurisë suaj ndaj pasurisë dhe frikës nga vdekja.”*

Është e njohur se dashuria e tepër ndaj pasurisë, e privon njeriun nga kënaqësia dhe se si pasojë e ruajtjes së tepërt të jetës është rreziku më i madh nga shkatërrimi. Këto janë zakonet e Zotit në botë apo ligjet natyrore, si thuhet sot.

Kur’ani e urdhëron myslimanin që në rrugën e Zotit ta urrejë jetën dhe pasurinë dhe çdo gjë që është e çmuar, i urdhëron të jetë i qëndrueshëm dhe të mos e humbasë shpresën e të pikëllohet, të jetë i durueshëm dhe të mos luhatet çkado që t’i ndodh në jetë. Shohim se si thuhet:

“Sa e sa Pejgamberë bashkë me shumë besimtarë të vërtetë luftuan, e megjithatë nuk u përulën për ato i goditën në rrugën e All-llahut, as nuk u demoralizuan as nuk u dobësuan. All-llahu i don durimtarët.” (Ali Imran: 146).

Kështu don Zoti që të jenë myslimanët, e nëse nuk janë të këtillë, siç thuhet kategorikisht në Kur’an, atëherë si mund të kërkojnë nga Zoti që t’i përmbushë premtimet e Veta në ndihmë, forcim, mirëqenie dhe siguri?!

Ndër faktorët më të mëdhenj të prapambeturisë të myslimanëve, bën pjesë edhe konservatizmi kryeneç. Ashtu siç janë për Islam të rrezikshëm ata që dëshirojnë të abrogojnë çdo gjë që është e vjetër, pa marrë parasysh a është e dëmshme apo e dobishme ajo, po ashtu për Islam janë të rrezikshëm edhe konservatorët, të cilët në asgjë nuk pranojnë ndërrime dhe të

cilët nuk pranojnë të bëhet kurrnjë përmirësim, sado i vogël të jetë ai, në arsimimin islam, duke pandehur se të marrësh si shembull jobesimtarin paraqet mosbesim dhe se arsimimi modern është shpikje e jobesimtarëve. Pra Islamin e kanë shkatërruar ateistët dhe konservatorët.

Ateistët vetëm dëshirojnë që t'i evropizojnë myslimanët dhe njerëzit e tjerë të Orientit, që t'ua fshijnë të gjitha tiparet dhe karakteristikat e tyre, që t'i shtyjnë ta mohojnë të kaluarën e tyre dhe t'i bëjnë elemente kimike me përmbajtje të tipit krejtësisht tjetër e që të shkrihen në të duke humbur kështu esencën e tyre. Kjo prirje për mohimin e të kaluarës së vet dhe pranimi se të parët e tij kanë qenë të ulët dhe se dëshiron të heq dorë prej tyre, mund të rrjedh vetëm nga njeriu pa cipë, nga mizori apo nga ai që është i vetëdijshëm për origjinën e vet bataçinsh andaj përpiqet që ta mohojë edhe origjinën e tërë popullit të vet, duke e ditur se vet është njeri mizor dhe se vetë nuk ka pjesë në bujarinë e tërë popullit të vet. Kjo është në kundërshti me ligjet të cilat në çdo popull i ka vënë prirja natyrore për ruajtjen e veçorive të veta siç janë gjuha, feja, zakonet, ushqimi, pija, banesa etj.

Të shikojmë Evropën - ngase ajo sot në këtë paraqet idealin më të madh - dhe do të shohim se kurrnjë popull i saj nuk dëshiron të asimilohet në ndonjë popull tjetër. Anglezët dëshirojnë të mbesin anglezë, francezët francezë, gjermanët donë të mbeten gjermanë, italianët nuk pranojnë të jenë asgjë tjetër pos italianë, qëllimi skajor i rusëve është të mbesin rusë

e kështu me radhë. Ky shembull më shumë ndikon në shpirt kur dihet se, për shembull, irlandezët - popull i vogël fqinj i anglezëve, të cilët mbi shtatëqind vjet kanë bërë përpjekje maksimale, çfarë vetëm mund të paramendohet, vetëm për t'i asimiluar ata, - nuk kanë dashur të bëhen anglezë, por kanë mbetur irlandezë me gjuhën e vet, me besimin e vet, me shijen dhe me zakonet e veta.

Edhe brenda vetë Francës, bretonasit me çdo kusht kanë dashur ta ruajnë origjinën e vet. Në jug të Francës ekziston një fis, i quajtur Baskë, të cilët e kanë ruajtur kombësinë e tyre ndaj gotëve, arabëve, spanjollëve dhe së fundi ndaj francezëve, e gjithsej janë një milion frymë. Ata edhe sot e ruajnë gjuhën, veshjen, zakonet dhe shprehjet e veta. Flamandët nuk kanë dashur të pranojnë gjuhën frënge e as arsimimin francez, por vijimisht e kanë ngritur zërin e vet në Belgjikë, saqë në fund Franca ka qenë e detyruar të pranojë gjuhën e tyre si gjuhë zyrtare.

Zvicra është e përbërë prej tri kombesh. Gjermanë janë 2.800.000. Ata që flasin frëngjisht janë 800.000, që flasin italisht janë shumë më pak, rreth 200.000, dhe çdo komb ruan gjuhën e vet, zakonet e veta dhe aspiratat e veta, edhe pse politikisht të gjithë janë një dhe jetojnë në një shtet.

Danimarka, Skandinavia dhe Holanda, pa dyshim janë degët e trungut gjerman, por asesi nuk lejojnë që të asimilohen në gjermanë, e as që dëshirojnë ta braktisin kombësinë e tyre. Çekët kanë jetuar me qinda vjet nën sundimin e gjermanëve,

mirëpo prapëseprapë kanë mbetur çekë dhe pas Luftës Botërore e kanë kthyer pavarësinë e vet politike, pasi që e kanë ruajtur gjuhën e vet dhe pavarësinë e vet nacionale gjatë pesë shekujsh. Gjermanët i kanë kultivuar hungarezët, i kanë arsimuar dhe i kanë përparuar, por nuk kanë mundur t'i asimilojnë, dhe ata më tepër se çdo popull tjetër e ruajnë gjuhën me prejardhje mongole dhe kombësinë e vet hungareze.

Rusia e madhe dy-tre qind vjet radhazi ka tentuar t'i asimilojë polakët dhe t'i shtojnë që ta harrojnë kombësinë e tyre, duke e arsyetuar me atë se edhe polakët janë sllavenë sikurse edhe rusët, e më në fund, të gjitha përpjekjet për asimilimin e polakëve, të cilët pas Luftës Botërore bëhen tërësisht të pavarur, u shkuan huq. Këtë e kanë arritur vetëm për atë se asnjë moment nuk e kanë braktisur nacionalizmin e vet.

Nuk është për t'u çuditur se një popull që numëron tridhjetë milion, nuk lejon të asimilohet, mirëpo as Estonët, të cilët janë gjithsej dy milion, nuk pranuan që të asimilohen në rusë, por u shkëputën prej tyre dhe e ripërtërinë pavarësinë e vet dhe gjuhën e vet me prejardhje mongole, për të cilën edhe krijuan alfabetin. Në të njëjtën mënyrë kanë vepruar edhe finlandezët të cilët u shkëputën nga Rusia. Madje rusët nuk mundën t'i asimilojnë nga popujt baltik as lituanezët, por edhe ato dolën pavarësisht siç kanë qenë kombësisht të pavarur, e gjithsej janë katër milion. Fqinjët e tyre letonët janë më pakë, vetëm dy milion, por megjithatë pas Luftës Botërore u

shkëputën dhe formuan republikën e vet, sikurse republikat e tjera baltike, ngase që nga krijimi kanë ruajtur gjuhën e vet dhe kombësinë e vet. Rusët mbetën të pafuqishëm që t'i asimilojnë këta popuj, si nuk u shkoi për dore nga ana tjetër edhe gjermanëve që t'i bashkangjesin popullit të vet tejet të madh, ngase asnjë popull, sado që të jetë i vogël, nuk dëshiron ta mohojë preardhjen e vet dhe të heq dorë nga pavarësia e vet kombëtare. Kroatët e kanë ruajtur pavarësinë e vet kombëtare edhe pse janë të rrethuar nga dy popuj të mëdhenj: më latinët dhe me gjermanët, ndërsa serbët e kanë ruajtur pavarësinë e vet edhe pse mbi ta kanë zotëruar turqit shekuj me radhë. Shqiptarët që prej kur mbahet mend kanë mbetur shqiptarë, edhe pse gjenden në mes të dy popujve të mëdhenj: grekëve dhe sllavenëve. Po ashtu edhe bullgarët, të cilët kanë qenë në mes të grekëve, sllavenëve dhe latinëve, nuk kanë dashur diç tjetër, por të mbeten bullgarë. Pastaj u erdhën turqit, e ata e mësuuan gjuhën turke, mirëpo megjithatë mbetën bullgarë.

Duke parashtruar argumente, nuk dëshiroj të dalë jashtë Evropës, ngase ai grusht të pafesh atëherë do të thonin se nuk dëshirojnë të marrin për vete si ideal popujt të cilët kanë mbetur prapa sikurse edhe ata. Pra, të gjithë popujt që i përmenda si argument, janë evropianë, të gjithë janë të arsimuar, përparimtarë, të gjithë kanë kulturën e vet dhe shtetin e rregulluar dhe të gjithë kanë universitetet e veta, akademitë, bashkësitë shkencëtare, armatën, marinën etj.

Megjithatë, do të dalë nga rajoni i Evropës vetëm në Japoni, ngase përparimi i tyre është i ngjashëm me atë të Evropës, ndërsa e kanë arritur sikurse edhe evropianët në suaza të kombësisë së tyre, gjuhës, letërsisë, lirisë, fesë, zakoneve, veçorive... Po ia parashtroj lexuesit një pjesë nga një artikull tjetër, i cili ka arritur nga një korrespondent evropian, i cili udhëton nëpër Japoni, e që ka dalur në revistën “Journal de Geneve”, më 20 tetor. Aty thuhet:

“Japonezi e don artin e vet. Nëse e sheh se punon për të fituar pasuri, këtë e bënë me qëllim që t’i kënaqë aspiratat e veta për bukurinë. Ai, përveç simpatisë ndaj bukurisë, në shpirtin e vet e ka skalitur ndjenjën nacionale, ngase mburret që japonezët gjatë vetëm afro gjashtëdhjetë vitesh janë bërë nga populli mesjetar feudal një nga popujt më të mëdhenj të botës. Nuk ka kurrfarë dyshimi se feja japoneze ka pasur rol të madh në politikën japoneze (le të mendojë lexuesi për këtë!), e ajo në esencë është filozofi e cila bazohet në pranimin e të gjitha atyre që u kanë lënë stërgjushërit pasardhësve. Japonezi bashkëkohor i është adaptuar të gjitha nevojave jetësore bashkëkohore, porse ka mbajtur pretendimin e vijueshëm që gjithnjë t’i kthehet të kaluarës së vet dhe që fuqimisht t’i mbahet nacionalizmit të vet duke i bërë rezistencë thirrjes që të evropizohet (në origjinal qëndron oksidentalizohet, d.m.th. të bëhet perëndimor) dhe pranon nga evropianët atë që është e domosdoshme për luftë kundër popujve të tjerë. S’ka dyshim se ky është shembulli i vetëm në historinë e popujve të Lindjes së Lartë.”

Shkrimtari më tej vazhdon:

“Japonezët i urrenin udhëtimet në vendet e largëta dhe kanë penguar hyrjen e të huajve në atdheun e tyre, porse këtë përparimi bashkëkohor e ka shlyer dhe Japonia, çdo gjë të kaluar e ka kompensuar në mënyrë kolosale. Rezultatet janë para nesh, ngase ata në këtë të kaluarën e shenjtë i konceptojnë vlerat e veta bashkëkohore. Ne i shohim se si luftojnë me mjete më moderne të botës bashkëkohore, pa të cilat në kohën tonë nuk ka jetë, duke mohuar çdo oksidentalizim, vetëm për atë se janë të vetëdijshëm se kjo nuk u duhet, kurse nga ana tjetër me kënaqësi i kthehen ndjenjave të tyre nacionale sipas të cilave besojnë se janë më autoritativ në botë.

Posedojnë tempuj “shinto”, faltore “zen” dhe pagoda budiste të cilat i respektojnë, i çmojnë dhe shërbejnë me pasion më të madh fetar dhe bindshmëri të fuqishme sikurse edhe shumë shekuj më parë. Në të vërtetë, ky respekt i madh që japonezët ndiejnë për të kaluarën dhe perënditë e tyre, tek ta formojnë një beden të fortë kundër ideve nacionaliste dhe komuniste.”

Ka disa vjet që ka dalur në Francë një vepër e re mbi Japoninë nga markizi La Mazelier. Gazetat kanë folur shumë për të dhe revista “Debats” ka shkruar një artikull kumbues për të, andaj u rekomandojmë lexuesve, të cilët dëshirojnë të kuptojnë se si ka përparuar Japonia (e kjo është temë me vlerë të madhe, ngase mund të tërhiqen konsekuencat për vendet e tjera të Lindjes), që ta lexojnë këtë vepër, autori i së cilës nuk

mund të akuzohet për partizani në favor të Japonisë, e më duket se kjo vepër kryesisht është e përputhshme me historitë që i kanë shkruar specialistët historianë japonezë. Këto vepra janë përkthyer nga japonishtja në frëngjishte. E ndiej veten të obliguar që në këtë artikull, të shkruar shpejtazi, të përcjellë disa fragmente nga vepra e përmendur e La Mazelierit. Kështu, duke folur për qytetërimin bashkëkohorë të Japonisë dhe daljes së këtij populli nga të rezervuarit (veçuarit) e lashtë, ai thotë:

“Japonia filloi të pranojë nga Evropa dhe Amerika diç nga kultura e tyre materiale, nga rregullimi ushtarak, arsimimi i përgjithshëm dhe politika financiare. Kështu reformatorët e tyre bënë përpjekje që nga secili popull të pranojnë atë që është më së miri tek ata, dhe pasojat e kësaj janë treguar në çdo fushë, e kjo pastaj ka shërbyer si projekt i ripërtëritjes, i rrëzimit dhe i ngritjes së jetës japoneze.” Më tej flet për luftën japanezo-kineze dhe përfundon me fjalët të cilat i përkthejmë tekstualisht:

“Fitorja e Japonisë ndaj Kinës nuk ka argumentuar vetëm superioritetin e ideve dhe parimeve shkencore, të cilat Japonia i pat pranuar nga Perëndimi, por ka argumentuar edhe diç tjetër, e kjo është se një popull aziatik vetëm me vullnetin dhe vendosmërinë e vet ka ditur të zgjedh nga qytetërimi perëndimor atë që ka pretenduar se i nevojitet më së tepërmi (mendo mirë!), duke ruajtur njëkohësisht pavarësinë e vet, nacionalizmin, ideologjinë, letërsinë dhe arsimimin.”

Më parë i kam përshkruar shkurtimisht nëpër gazeta (e ajo që kam shkruar është vetëm një pikë ujë nga deti) solemnitetet e japonezëve, me rastin e kurorëzimit të mbretit të tyre para dy vitesh. Kam parashtruar se si ceremonitë e këtij solemniteti kanë zgjatur plot një muaj dhe, se si Mikado është prifti më i madh i atij populli. Kam thënë se atë e konsiderojnë si pasardhës të perëndisë Diellit, kam parashtruar se si lahet në banjë të shenjtë, e cila ruhet që dy mijë vjet, ka ngrënë me zotin oriz të shenjtë, të cilin shteti e ka mbjellur nën mbikëqyrjen e priftërinjve, në mënyrë që pa kurrfarë dyshimi të jetë tërësisht i shenjtë, dhe se në atë solemnitet kanë marrë pjesë 600.000 japonezë, të cilët brohoritnin: “Rroftë Mikado 10.000 vjet!” etj.

O Zoti im! Përse Japonia është duke përparuar me shpejtësi të hatashme dhe përparimi i këtij populli bashkëkohor shërben si shembull, duke qenë se është i dhënë pas dogmave, zakoneve dhe shprehive të vjetra dy mijë vjet dhe kur sundimtari i saj është prifti më i madh, e për ta nuk thuhet se janë prapanikë? (Nëse japonezët janë prapanikë, atëherë unë e përshëndes këtë prapanikësi!) Përse sundimtari anglez dhe mbreti i Indisë - i cili është sundimtar i 400 milion njerëzish në botë, të cilët i takojnë racës së bardhë, të zeshkët, të verdhë, të kuqe dhe të zezë - kryet e kishës anglikane, në tubimet e së cilës diskutohet se a janë vera dhe buka vetë shugurimin trupi dhe gjaku apo vetëm simbole dhe alegori? A mund të thuhet për të se është prapanik apo për shtetin e tij se është i prapambetur apo jopërpatimtar?

Nëse Anglia është e prapambetur, atëherë sa prapambeturi e bukur qenka kjo!

Përse kontinenti evropian është i tëri i krishterë, dhe përse në çdo rast mburret me krishterimin e vet; përse është i bashkuar në këtë punë përkundër armiqësisë dhe zilisë së ndërsjellë, e ne nuk i akuzojmë se prapanikë, edhe pse pasojnë fenë e vjetër dymbëdhjetë shekuj? Për dispozitat të cilat datojnë qysh para nëntëmbëdhjetë shekujsh mund të thuhet se janë të vjetra dhe shumë të vjetra. Hebrenjtë dhe të krishterët mburren me Teuratin (Toren) e tyre, i cili është i vjetër me mijëra vjet, e mu hebrenjtë janë ata, të cilëve - deshe-s'deshe - duhet t'ua pranojmë aftësinë, mendjemprehtësinë, dëshirën për punë dhe zellin e madh.

Përse e shohim rininë bashkëkohore përparimtare hebreje, duke luftuar për mbrojtjen e gjuhës së vet, historia e së cilës është e panjohur, ngase depërton në kohët shumë të lashta? Megjithatë, për ata nuk thuhet se janë prapanikë dhe të prapambetur. Weizmanni, kryetar i Union Cionistik, në revistën "Matin" ka botuar bisedimin në të cilin thekson se gjëja më e rëndësishme, me të cilën mburret dhe, të cilën e konsideron si shërbim të cilin njerëzimi nuk duhet t'ua harrojë cionistëve, ajo që e tërë Palestina e Re sot flet me gjuhën e të Dërguarit të Zotit. Nën "Palestinën e Re" mendon Palestinën hebreje, ku cionistët kanë ringjallur gjuhën e vjetër hebreje, dhe ku kanë përqafuar gjuhën hebreje. Kush e ka bërë këtë? Këtë e kanë bërë hebrenjtë bashkëkohorë, të cilët më ashpërsisht i

përmbahen parimeve të shkencës së re dhe të kulturës bashkëkohore (*“Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim.”*)...

Çka do të numëroja më tej shembujt dhe mësimet në një broshurë të vogël siç është kjo?! Çdo popull i mbahet fesë së vet, veçorive dhe karakteristikave të trashëguara, por vetëm myslimanëve ua shohin për të madhe këtë. Kur dikush t'i thërret që t'i përmbahen Kur'anit të vet dhe mësimëve të veta, veçorive dhe karakteristikave të veta, gjuhës dhe letërsisë arabe, jetës orientale dhe drejtimit të tij, bëjnë zhurmë të madhe ata që i kanë zemrat e helmuara, duke britur: “Poshtë prapanikët!” dhe thonë: “Çfarë përparimi dëshironi, kur u përmbaheni shprehive të vjetra të cilat kanë mbetur nga shekulli i mesëm, e ne jetojmë në këtë kohë?!”

Ja, të gjithë këto krijesa mësuan, përparuan, u ngritën, u lartësuan dhe fluturuan në qiell, e i krishteri i mbeti besnik Ungjillit dhe zakoneve kishtarë, hebrenjtë Tores dhe Talmudit, e japonezët statujave të veta dhe orizit të shenjtë, dhe çdonjëri prej tyre është i kënaqur me atë që ka. Vetëm myslimani i gjerë nuk mund të përparojë ngase nuk don që ta flakë Kur'anin e vet, dogmën e vet, burimet e veta, traditën, shprehitë, maniret, veshjen, mobilet, gjellën, pijen, zbavitjet etj. dhe se nuk dëshiron të heqë dorë nga e tërë e kaluara e vet. Nëse nuk vepron kështu, nuk i parashohin përparim. Ja, këto janë dëmet e jobesimtarëve, të cilët ia dojnë të keqen Islamit dhe të tërë Lindjes, dhe i mashtrojnë naivët me trillimet e tyre

Na mbetet të flasim për konservatorin kokëngjeshur, i cili nuk është më pak i rrezikshëm se jobesimtari, edhe pse ai nuk participon dhe nuk merr pjesë në shpirtligësinë e tyre dhe në qëllimet e këqia të tyre, porse vepron nga mosdija dhe fanatizmi. Konservatori kokëngjeshur është ai i cili ua ka përgatitur terrenin armiqëve të qytetërimit islamik, që të luftojnë kundër tij, duke konfirmuar se prapmbeturia në të cilën gjendet bota islame është fryt i doktrinës islame. Konservatori kokëngjeshur është shkaktar i varfërisë në të cilën kanë rënë myslimanët, ngase Islamin e ka bërë vetëm fe të asaj bote, e Islami në realitet është fe edhe e kësaj bote edhe e asaj bote, dhe kjo është mu karakteristika dalluese e saj që nuk posedojnë fetë e tjera. Islami nuk e ka kufizuar punën e njeriut vetëm në atë botë, siç kanë bërë fetë në Indi, dhe në Kinë, as që njeriun e ka privuar nga pasuria, nga pushteti dhe nami i kësaj bote, siç e bënë këtë mësimi i Ungjillit, e as që i ka koncentruar përpjekjet njerëzore në gjërat e kësaj bote, siç e bënë këtë qytetërimi bashkëkohor i Evropës.

Konservatori kokëngjeshur është ai i cili u ka shpallur luftë shkencave natyrore, ekzakte dhe filozofike, artit dhe zejeve, duke pandehur se këto janë shkenca të jobesimtarëve. Me këtë ai e ka privuar Islamin nga frytet e këtyre shkencave, pasuesve të tij u ka shkaktuar varfërimin në të cilën gjenden sot, dhe me këtë ua ka prerë krahët, sepse shkencat natyrore janë ato që hulumtojnë tokën, e toka ia hapë thesaret e vet vetëm atij që e hulumton atë. Nëse ne, gjatë të jetës sonë, do të flisnim vetëm

për gjërat që kanë të bëjnë me botën tjetër, toka do të na thoshte: “Shkoni drejtpërdrejt në atë botë, ngase tek unë për ju nuk ka asgjë!”

Ne, duke i koncentruar të gjitha përpjekjet tona në shkencat dhe diskutimet mbi atë botë, e kemi vënë veten në situatë të palakmueshme kundruall popujve të tjerë, të cilit ia kanë kushtuar vëmendjen e tyre kësaj bote, andaj ata në të gjithnjë janë duke përparuar e ne gjithnjë zhytemi, kështu që të gjitha i kanë marrë në duart e veta dhe janë në gjendje që, jo vetëm të na privojnë nga pasuria, por të na kthejnë edhe nga feja jonë. Kjo nuk është ajo që Zoti kërkon prej nesh kut thotë: ***“All-ahu u ka premtuar disave prej jush, që kanë besuar dhe që punojnë vepra të mira - se do t’i bëjë sundimtarë në Tokë”*** (En-Nur: 55) dhe ***“Thuaj: “Kush i ka penguar stolitë e All-llahut, të cilat, Ai i ka krijuar për robërit e Vet, dhe ushqimet e këndshme?” Thuaj: “Ato janë për besimtarë në këtë botë (dhe për të tjerët); e, në botën tjetër, vetëm për besimtarë*** (El-Araf: 32). Më tej All-llahu thotë në ato dispozita të mëhershme të sheriatit, të cilat i ka përmendur në Kur’an dhe i ka mbajtur: ***“Por mos e harro as pjesën tënde në këtë botë”*** (El-Kasas: 79). Zoti na ka mësuar që Ta lusim me këto fjalë: ***“Zoti ynë, jepna të mira në këtë jetë dhe në jetën tjetër!”*** (El-Bekare: 201) etj.

Myslimani konservator kokëngjeshur nuk e di se me këtë drejtim i kontrbuon shkatërrimit të popullit të vet dhe se me këtë e vënë popullin e vet nën nivelin e popujve të tjerë. Ai nuk

i vërenë fatkeqësitë që janë grumbulluar, për arsye se populli i tij i ka lënë pas dore shkencat natyrore, e ka rënë në skamje të tanishme dhe në zgjedhën e armiqëve të vet, të cilët nuk u përmbahen obligimeve e as fjalës së dhënë. Kur myslimani i tillë vërenë një gjendje të tillë, këtë e shpjegon, duke mos menduar më thellë, me fatin (kësmetin). Në këtë mënyrë, zakonisht e fajësojnë fatin të gjithë përtacët e kësaj bote.

Këto krijesa ua kanë bërë përtacinë të këndshme shumë myslimanëve, andaj në mesin e tyre vihet një grup njerëzish të cilët e quajnë veten dervishë dhe nuk mirren me asgjë. Këta në të vërtetë janë vetëm gjymtyrë të thara të trupit të bashkësisë islame.

Këto krijesa janë pikërisht ata, të cilët u kanë dhënë shkas evropianëve, duke konfirmuar se Islami predikon determinizmin dhe nuk japin inkurajim për punë, ngase ajo çka do të ndodhë - do të ndodhë doemos, u angazhua njeriu apo jo.

Nuk ekziston argument më i fuqishëm për pambështetshmërinë e këtij konfirmimi evropian se Kur'ani, i cili është përplotë inkurajime për punë, nxitje për iniciativë dhe i cili gjithnjë lidh shpërblimin dhe ndëshkimin, suksesin dhe mossuksesin, për atë që bën njeriu i pjekur. Zoti thotë: ***“Dhe thuaj: “Punoni, All-llahu, Pejgamberi i Tij dhe besimtarët do të shohin punën tuaj.”*** (Et-Teube: 105). ***“Thuaj: “A mos doni të polemizoni ju me ne, për kompetencat e All-llahut - kur Ai është Zoti ynë dhe juaj? Na i kemi veprat tona e ju tuajat.”*** (El Bekare: 139). ***“O ju që keni besuar! Përruljuni All-llahut***

dhe përlunji Pejgamberit (të Tij) dhe mos i prishni veprat tuaja!” (Muhammed: 33). “All-llahu është me ju dhe kurrë nuk do t’jua pakësojë shpërblimin e veprave tuaja.” (Muhammed: 35). “Nëse i bindeni All-llahut dhe Pejgamberit të tij, All-llahu nuk do të pakësojë asgjë nga veprat tuaja.” “Me të vërtetë, çdonjërit prej tyre, Zoti yt do t’ia plotësojë pagimin për veprat e tyre. Se, Ai, me të vërtetë, është i njoftuar për atë që punojnë ata.” (Hud: 111). “...Që All-llahu plotësisht t’ua shpaguajë veprat e tyre dhe nuk do t’ju bëhet atyre padrejtësi.” Unë assesi nuk do t’ia shkatërroj veprat askujt prej jush”. “Shpërblimi i mirë është për ata që punojnë mirë.” “Për këtë (shpërblim) le të punojnë njerëzit!” “Vetëm All-llahut i shkon fjala e bukur dhe ajo i lartësonë veprat e mira.” “Çdokujt do t’i jipet ajo që ka fituar.” (El-Bekare: 281). “Kush punon vepra të mira - qoftë mashkull apo femër - e është besimtar, Ne do t’i japim atij që të kalojë jetë të bukur. Dhe, me të vërtetë, për veprat që kanë punuar, do t’i shpërblejmë ata me shpërblim më të mirë se që e kanë merituar.” (En-Nahël: 97). “Ditën e gjykimit çdonjëri do të gjejë të gatshëm atë që ka punuar mirë, e për të keqen që ka bërë do të dëshirojë të jetë larg tij.” “Secili do të shpërblehet për veprat e veta, e All-llahu e di më së miri se çka kanë bërë ata.” “U kanë arritur pasojat e këqija të veprave të tyre.” “E gjetën të gatshëm at që kanë punuar.” “Që t’u japë të shijojnë një pjesë nga ajo që kanë punuar.” (Er-Rum: 41). “Përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, për ta ka

shpërblime të pandërprera.” (Et-Tin: 6). *“Për të gjithë do të ketë shkallë të caktuar, për atë që kanë punuar, për t’i shpërblyer (dhe dënuar) sipas veprave të tyre - e nuk do t’ju bëhet atyre padrejtësi.*” (El-Ahkaf: 19). *“Kush bën një të mirë, sa do e vogël të jetë ajo, nuk do t’i humbas, e kush bën një të keqe, sa do e vogël të jeta ajo, nuk do t’i humbas.” “Do të shpërblehen sipas veprave që kanë bërë.” “Dhe u tha atyre: “Shijone atë që keni fituar!”* Kështu do të mund të numërohen shumë ajete, çfarë ka shumë në Kur’an, e prej të cilave disa shprehimisht i përkasin çështjes sonë, si për shembull: *“Fatkeqësitë që ju godasin, janë pasoja të veprave tuaja.” “Kur t’ju godet ndonjë fatkeqësia, të cilën e fituat dyfish, a mos do të thoni: “Prej nga na erdhi neve kjo?!” Thuaju: “Kjo është prej vetë juve”.*

Zotëriu që ma pat parashtruar një pyetje e di mirë, e shumica e myslimanëve nuk e di, se këtë ajet All-llahu u ka drejtuar besimtarëve dhe pasuesve më të përsosur të Islamit, përkatësisht shokëve të të Dërguarit të All-llahut, ngase janë habitur se si i ngadhënjyen paganët në Uhud. Zoti u parashtron shkaqet, pikërisht për atë se e shkelën urdhrin e Resulull-llahut s.a.v.s. që u pat dhënë shigjetarëve, të cilët e mbronin prapavijën e luftëtarëve, që të mos i braktisin pozitat e tyre përkundër asaj se a janë duke fituar apo duke humbur myslimanët. Mirëpo, pasi paganët qenë thyer, ata e shkelën urdhrin dhe u nisën që t’u bashkohen luftëtarëve në prenë e

luftës, por paganët përsëri sulmuan (dhe i mundën myslimanët) me ç'rast që i plagosur në kokë edhe Resulull-llahut s.a.v.s. etj.

Të gjitha këto ajete flasin se Islami është fe e punës, e jo fe e përtacisë e as mbështetje e njerëzve në fatin e panjohur, siç konfirmojnë dervishët përtacë se Zoti është i obliguar të na furnizojë punuam ne apo jo. Gjithashtu, disa shkrimtarë evropianë pohojnë se Islami është fe e konservatizmit kokëngjeshur, e traditave dhe e përkushtimit (fatit), ndërsa prapambeturia e myslimanëve rrjedh vetëm nga këtu.

Sikur në këtë pohim të kishte madje edhe pak të vërtetë, nuk do të ngriteshin shokët e Resulull-llahut s.a.v.s., të cilët më së miri e kanë njohur Islamin, e ta pushtojnë gjysmën e rruzullit tokësor brenda pesëdhjetë vitesh. Të dorëzuarit (fatit), për të cilin flasin e dërdëllisin, është i bashkuar me punë, me angazhim dhe me përpjekje, meqë përndryshe nuk do të quhej dorëzim (përkushtim), porse rezignim (pajtim me fatin) dhe përtaci, të cilat janë në kundërshtim me Kur'anin dhe Sunnetin. Nëse të dorëzuarit vullnetit të Zotit është i ngarkuar me punën, atëherë kjo është me e dobishme edhe për këtë botë edhe për botën tjetër, ngase vetëbesimi i tepruar e hedh njeriun në çapkëneri kur ka sukses, dhe në ligështi, kur nuk ka sukses. Ndërkaq, Islami kërkon që njeriu më së pari të lidhë diç e pastaj të mbështetet në Zotin, që me mendjen e vet, të cilën ia ka dhënë Zoti për ta udhëhequr, të mendojë, e ta dijë se gjithçka nuk është nën pushtetin e tij dhe se ekziston fati, të cilin arsyeja nuk mund ta kuptojë. Kjo është plotësisht e vërtetë. Kur

Resulull-llahut s.a.v.s. e kishte përmendur fatin, disa nga shokët e kishin pyetur: “A do të mbështetemi në fatin?” Në çka është përgjigjur: *“Punoni, ngase secilit i është mundësuar ajo për çka është i krijuar!”* Këtë shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

Gjëja më e çuditshme është se si evropianët, të cilët Islamin pandërprerë e kualifikojnë si determinizëm dhe si prapambeturi të myslimanëve, ia përshkruajnë kësaj dogme (të cilën e përfaqësojnë vetëm një numër i vogël myslimanësh), i harrojnë ato provra mbi fatin, të cilat gjenden në Ungjill me masë sa në Kur'an apo edhe më tepër. Për shembull: “Nuk bie kurrnjë qime nga koka juaj pa lejen e atit tuaj qiellor” dhe shumë proverbe të ngjashme me këtë, të cilat do të na shpienin larg sikur të tentonin t'i parashtronim që të gjitha. Të gjithë evropianët që janë të dashuruar në punë, janë të entuziazmuar pas fitimit dhe përgjithësisht mohojnë fatin, lexojnë Ungjillin, e konsiderojnë për të shenjtë dhe mahniten sikurse edhe ne me parimet e lartësuara të tij. Përse ata i harrojnë proverbat e tij, të cilat kanë të bëjnë me fatin? (Një herë lejojnë, e një herë tjetër këtë e ndalojnë). Të gjitha proverbat e Kur'anit dhe të Ungjillit mbi fatin, në të vërtetë don të thonë se Dituria e Zotit i paraprinë çdo gjëje që ndodh, e assesi me këtë nuk pretendohet mohimi i vullnetit të lirë dhe të kthyerit nga puna. Në anekdotën mbi sasinë dhe sasi të dhe ne rrëfimet e tjera të Ungjillit gjendet ajo që Kur'ani i përshkruan librave të Ibrahimit dhe të Musait dhe librave tjera të Pejgamberëve të tjerë. Kjo është: “Çdonjëri përgjigjet për veprat e veta. Njeriut i

takon vetëm ajo që fiton; angazhimi i tij vërtet do të mirret parasysh, e tërësisht do të jetë i shpërblyer.”

T’i kthehemi myslimanit, konservatorit kokëngjeshur. Ai ua ka hapur rrugën armiqëve të Islamit kundër Islamit dhe ua ka mundësuar që të flasin keq për të, duke pohuar se kjo është fe e cila nuk përputhet me përparimin bashkëkohor dhe fe e cila pengon qytetërimin. Në të vërtetë, përfaqësimi i këtyre konservatorëve nuk përputhet me qytetërimin dhe ata e pengojnë përparimin bashkëkohor, ndërsa Islami nuk ka asgjë të përbashkët me konservatorizmin e tyre kokëngjeshur.

Në esencë, Islami është revolucion kundër botëkuptimeve të vjetra, që nuk vyejnë, ndërprerje me të kaluarën e pavlefshme, ndërprerje me çdo gjë që nuk është e vërteta, e si atëherë të jetë kjo fe e konservatorivizmit kokëngjeshur?! Duke folur për Ibrahimin, në Kur’an thuhet: **“Kur i tha babës së vet dhe popullit të vet** (Esh-Shu’ara: 70): **“Çfarë janë këta idhuj që i adhuron ju?” Ata u përgjigjën: “I kemi gjetur të parët tanë duke i adhuruar.” Ai u tha: “Ju dhe të parët tuaj jeni në lajthitje.”** Në Kur’an më tej qëndron: **“Ata u përgjigjën: “Adhurojmë idhujt, dhe përherë u jemi të prirur atyre!”** (Esh-Shu’ara: 71) **“I kemi gjetur të parët tanë, që bënëin kështu.”** (Esh-Shu’ara: 74). (Ibrahimi) tha: **“E, a po vëreni ju, se ç’po adhuron - ju dhe të parët tuaj të lashtë?”** (Esh-Shu’ara: 75) **Më të vërtetë, ata janë armiq të mi. E, nuk më është armik Zoti i Gjithësisë.”** (Esh-Shu’ara: 77) Në Kur’an qëndron: **“Ne i kemi gjetur të parët tanë në këtë fe dhe**

vazhdojmë gjurmëve të tyre". Ai tha: "A edhe nëse ju kam sjell rrugë më të mirë nga ajo që i gjetët të parët tuaj?" (Ez-Zuhruf: 23-24) "E kur atyre t'ju thuhet: "Ndiqeni Shpalljen (Kur'anin) e All-llahu!" - Ata përgjigjen: "Jo! Na ndjekim atë udhë në të cilën i kemi gjetur të parët tanë!" - Vallë! edhe atëherë kur të parët e tyre nuk kanë ditur asgjë dhe kur nuk kanë qenë në rrugën e drejtë ?! (El-Bekare: 170) Disa njerëz mendjelehtë thonë: "Ç'i kthei ata (myslimanët) prej kiblës kah e cila ishin drejtuar?" Thuaju: "Të All-llahut janë Lindja dhe Perëndimi. Ai e udhëzon kë të dojë e kë të dëshirojë në rrugën e drejtë, që cakton Ai".(El-Bekare: 142).

Ekzistojnë edhe shumë ajete të ngjashme, të cilat thirrin në revolucion kundër të vjetrës, nëse ajo është jo e shëndoshë dhe e papërshtatshme.

Ndërsa njerëzit, të cilët e kuptojnë Islamin në mënyrë të drejtë, përshëndesin çdo risi e cila nuk është në kundërshtim me fenë dhe nga e cila nuk duhet të frikësohemi nga e keqja. Unë nuk mendoj se ekziston diç që do t'ishte e dobishme për bashkësinë islame, e që është në kundërshtim me fenë, e cila është themeluar për t'i bërë njerëzit të lumtur. Ne i shohim njerëzit e arsimuar nga Nexhdi, të cilët janë myslimanët më të largët nga evropianët dhe evropizimi dhe me të largët nga qendrat e zbulimeve bashkëkohore, se si u përgjigjën, kur prej tyre kërkoi zgjidhje sundimtari Abdul-Aziz b. Seudi - Zoti e ndihmoftë! - përkitazi me telegrafin e patel, telefonin dhe automobilin; u përgjigjën se këto janë gjëra të dobishme dhe

risi të mira dhe se në Kur'an e në Sunnet nuk ka ndalesë shprehimore e as kuptimore për këtë. A nuk është më e dobishme që shteti të dijë për çdo ngjarje porsa të ndodhë ajo, e të mund të ndërmarrë ç'është e duhur? A nuk është më e dobishme për myslimanët që haxhiu për disa orë mund të kalojë rrugën, e cila dikur ka zgjatur disa ditë? E kam pyetur Muhammed b. Ali b. Turkiu, njërin nga alimët e Nexhdit, i cili gjendet në Mekë, për mendimin e tij rreth telefonit dhe telegrafit të patel. M'është përgjigjur: "Kjo çështje është zgjidhur dhe, gjëja nga aspekti sheriatik është e lejuar aq qartë saqë për këtë as që vlen të diskutohet."

Rezistenca ndaj risive nuk është vetëm karakteristikë e konservatorëve kokëngjeshur islamikë. Dihet se kisha krishtere i ka bërë rezistencë çdo lloj risie, qoftë ajo fjalë apo vepër, e pastaj e ndërronte mendimin dhe e lejonte atë. Kur Galileu pohonte se Toka rrotullohet kisha e shpalli atë heretik, ndërkaq edhe sot e tutje ekzistojnë priftërinj të cilët e konsiderojnë heretik çdonjërin, që nuk pranon krijimin e botës ashtu si e paraqet Teurati (Tora). Para dy vitesh, është gjykuar një profesor në gjyqin e njërit nga Shtetet e Bashkuara të cilit i është ndaluar ligjërimi për shkak se e miratonte teorinë e Darvinit, porse kjo nuk e pengoi shkencën në rrugën e zhvillimit të saj.

Edhe krishterët kanë konservatorë kokëngjeshur, siç kemi edhe ne. Konservatorët kokëngjeshur myslimanë luftojnë kundër çdo shkence përveç asaj fetare, e cila përbëhet në

imitimin e verbër në të cilën ata janë mësuar tanimë. Madje luftojnë edhe kundër atyre që i mbështeten vetëm Kur'anit dhe Sunnetit. Ata harrojnë se shkencat natyrore dhe egzegjeze - gjeometria, teknika, kozmologjia, mjekësia, kimia, gjeologjia - janë shkenca të dobishme për çdo shoqëri njerëzore sikurse edhe ato fetare, nëse jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, atëherë në atë tërthorazi.

Sa shumë u patën mësuar këto shkenca në Az-her, Emevi, Zejtun, Karevijun, Kordobë, Bagdad, Samarkand dhe në vende të tjera, atëherë kur Islami kishte sundimtarë të mëdhenj dhe njerëz të mëdhenj! Sa kolos i pat dhënë Islami, të cilët njësoj merreshin me filozofi dhe me fe dhe, të cilët njësoj i kultivonin traditën dhe shkencat egzegjeze. Në mes tyre është filozofi më i famshëm arab, i njohur edhe në Evropë, i cili njëkohësisht është i njohur edhe ndër juristët më të mëdhenj të shariatit.

Qytetërimi islam

Konfirmimi se Islami nuk ka mundur të krijojë qytetërim të veçantë, duke e argumentuar këtë me gjendjen e tanishme të tij, është përrallë e kulluar, të cilën e potencojnë disa armiq të Islamit nga jashtë dhe, disa renegatë të tij nga brenda. Të parët e bëjnë këtë në mënyrë që myslimanët t'i konfeksionojnë me odore evropiane, e të tjerët të mbjellin në botën islame farën e mosbesimit. Ne, nuk mohojmë ndikimin e fesë në qytetërim, por edhe nuk pranojmë se feja mund të jetë kriter i qytetërimit.

Shpeshherë dobësohet ndikimi i fesë në popull, dhe duke u liruar nga zgjedha e fesë prishen dhe demaskohen, për çka edhe shkatërrohen, e feja për këtë nuk është aspak fajtore. Nga ana tjetër, shpeshherë, faktorë të papritur të jashtëm me fe, e tundin qytetërimin e themeluar, apo e rrëzojnë atë që nga themeli, e feja për këtë nuk është fajtore. Atëherë, paraqitet dekadencia e myslimanëve për shkak të mosnjohjes së fesë apo për shkak të moskryerjes së dispozitave të saj, ashtu siç duhet. Kur zbatohet sheriat, ashtu siç duhet, Islami ishte i madh dhe i famshëm.

Qytetërimi islam është fakt rreth të cilit nuk mund të zihemi, ngase nuk ekziston ndonjë popull evropian - gjermanët, francezët, anglezët, italianët etj. - e të mos kenë vepra të shumta mbi qytetërimin islam. Sikur Islami të mos kishte qytetërim përparimtar, të lartësuar dhe të vërtetë, të cilit ai i ka dhënë vulën e vet dhe i cili bazohet në Kur'an dhe në Sunnet, dijetarët evropianë, të cilët janë të njohur me atakimet e tyre në Islam, nuk do ta përmendnin aq shpesh qytetërimin islam dhe nuk do t'i ligjëronin ngjarjet e tij, nuk do ta krahasonin me qytetërimet e tjera dhe nuk do t'i parashtronin karakteristikat me të cilat ai veçohet.

Qytetërimi islam është njëri ndër qytetërimet e njohura, me të cilin është rregulluar historia e përgjithshme botërore, i cili me veprat e veta të shkëlqyeshme i ka përmirësuar faqet e amshuara të historisë. Në kohën e Mensurit, Reshidit dhe Me'munit, Bagdadi ka arritur popullzimin, kulturën, luksin dhe pasurinë çfarë nuk e kishte arritur kurrnjë qytet as para tij, as

pas tij, deri në kohët më të reja. Ka pasur 2,5 milionë banorë. Basra qëndronte në vendin e dytë pas tij, dhe ka pasur gjysmë milioni banorë.

Damasku, Kajro, Halebi, Samarkandi, Isfahani dhe shumë kryeqytete të tjera të shteteve islame, kanë qenë shembuj për nga popullsia e madhe, objektet madhështore, komoditeti i banorëve, kultivimi i shkencave dhe themelimin e arteve të lloj-llojshme.

Kajrevani, Fejzi, Tilimsani (Tlemceni) dhe Maroko kanë qenë qytete aq të mëdha, saqë nuk ka pasur të ngjashëm për nga madhështia dhe popullsia në tërë Evropën gjer në kohën më të re. Kordoba ka qenë qytet i mrekullueshëm i Evropës, i cili i ka pasur 1,5 milion banorë dhe 700 xhami, përpos xhamisë më të madhe, për të cilën më pat thënë një inxhinierë, që ma pat dhënë në disponim qeveria e Spanjës, se në të kanë mundur të faleshin brenda 50.000 njerëz e në oborr të saj 30.000, andaj në këtë xhami të mrekullueshme kanë mundur të falen gjithsej 80.000 njerëz.

Kur i vizituam gërmadhat e Ez-Zehrit, pamë se ato janë mbeturinat e një qyteti e jo të një kështjelle dhe, kuptuam se zgjerohej në një sipërfaqe prej 900 m. gjatësie dhe 800 m. gjerësie. Spanjollët e quajnë qyteti i Ez-Zehrit. Inxhinierët, të cilët ishin të ngarkuar me gërmimin e mbeturinave të kështjellës, më thanë se shpresojnë që do të mund ta gërmojnë tërësisht brenda pesëdhjetë viteve. Mjafton të përmendet se, në shekullin XV sipas Isait, në Evropë nuk ka pasur ndonjë qytet,

as për së afërmi të ngjashëm me Granadën, i cili në periudhën e fundit të sundimit islam në Spanjë ka qenë kryeqytet i një shteti të vogël. Kur pat rënë në duar të spanjollëve, kishte gjysmë milioni banorë. Asokohe, në Evropë nuk ka ekzistuar asnjë qytet, që ka pasur banorë madje edhe për gjysmë më pak, ndërsa Alhambara (El-Hamra), në Granadë gjer më sot ka mbetur e pa konkurent.

Ky është vetëm një vështrim i shkurtër, i cili pasqyron rrjedhën e qytetërimit islam dhe të kaluarën e shkëlqyeshme të tij, e sikur të dëshironim që më hollësisht t'i parashtronim të gjitha gjërat e bukura dhe të mrekullueshme që kanë lënë myslimanët në tokë, do të duhej të shkruanim një mori broshurash.

Historianët evropianë, nën titullin “Qytetërimi islam”, kanë shkruar shumë vepra të shkëlqyeshme dhe kanë botuar shumë përmbledhje ilustrimesh tërheqëse. Ata historianë evropianë, të cilët janë kundërshtarë më të mëdhenj të Islamit, përkufizohen vetëm në ndërmarrje që ta zvogëlojnë rëndësinë e qytetërimit islam dhe të mohojnë se Islami është nismëtar i tij. Maksimumi që mund të bëjnë këta njerëz, është ajo që të mohojnë se myslimanët kanë zbuluar dituri të reja, dhe se të parët kanë zbuluar disa teori gjer atëherë të panjohura. Ato pohojnë se myslimanët janë vetëm ndërmjetës dhe punëtorë, të cilët kanë qenë urë midis Lindjes dhe Perëndimit. Mirëpo, këtë konfirmin nuk e pranojnë hulumtuesit të cilët e dinë se myslimanët kanë zbuluar shkenca të reja, kanë zbuluar të vërteta të reja dhe ide

të panjohura gjer atëherë, përpos asaj që shumë gjëra i kanë bërë më të rregullta dhe më të përsosura, i kanë mbjellur dhe i kanë bartur ato.

Tekembramja, nuk dimë për asnjë qytetërim në rruzullin tokësor, që nuk është mbeturinë e qytetërimeve të mëparshme, rezultat i gjinisë njerëzore, shuma e rezultateve të mendjeve të llojllojshme dhe fryt i intelektëve të popujve të ndryshëm.

Përgjigjja injorantëve dhe ziliqarëve të qytetërimit islam

Vallë, a janë duke harruar ziliqarët e Islamit dhe injorantët, të cilët konfirmojnë se Islami vetëm ka marrë, ka mësuar, ka imituar dhe i ka ndjekur të tjerët - se qytetërimi lindor, në kohën e paraqitjes së Islamit, tanimë ishte shkatërruar nga dhëmbët e kohëve, të cilat shkatërrojnë çdo gjë dhe se vetëm Islami e ka ripërtërirë atë, e ka ngjallur dhe, përsëri e ka ngritur në këmbë? A harrojnë se Islami, të shkatërruarën dhe të humburën përsëri e ka zbuluar dhe tanimë të harruarën e ka nxjerrë në dritë dhe, e ka zgjeruar me dritë, gjithsecilit ia ka bërë të dukshme, e veçanërisht e ka veshur me odoren islame dhe e ka stolitur me stolinë kur'anore, saqë edhe sot e mban atë vulë edhe në Lindje edhe në Perëndim, gjithkund?

Kjo i ka shtyrë shumë shkencëtarë evropianë, të cilët nuk ishin të verbëruar nga pasionet dhe të cilët në hulumtimet e tyre i përmbaheshin rrugës së drejtë - të pranojnë se, qytetërimi i

Islamit nuk ka qenë kopje, porse ka gufuar nga Kur'ani dhe ka shpërthyer nga monoteizmi.

Ato vepra, të cilat qytetërimi islam i ka përkthyer, shkencat të cilat i ka marrë nga të tjerët, të gjitha këto nuk e dëmtojnë aspak virgjëritetin islamik dhe namit arab. Të gjitha qytetërimet njerëzore marrin nga njëri-tjetri dhe e përsosin njëri-tjetrin, ndaj dituria e vërtetë është koncentruar në këtë hadith: *“Dituria është gjë e humbur; do ta kërkojnë madje edhe në Kinë”* Ky është një nga rregullat më të ndritshme të Islamit.

Si do qoftë, injoranti nuk mund të mohojë se Islami ka luajtur rol të madh në botë në pushtimet morale, intelektuale dhe materiale. Këto pushtime Islami i pat kryer brenda afro tetëdhjetë vitesh, gjë që, sipas pranimi të përgjithshëm, nuk i ka shkuar për dore kurrnjë feje më para. Napoleoni I, i mrekulluar me historinë islame, ka thënë në ujdhesën Helena e shenjtë: *“Arabët e kanë pushtuar botën vetëm për pesëdhjetë vjet.”*

Merre me mend, lexues i nderuar, se këtë e ka thënë ai Bonaparta, të cilit pushtimet gjithnjë iu kanë dukur të pakëta, sa do që të mëdha ishin ato. *“Në sytë e të parëndësishmit edhe gjërat e vogla janë të mëdha, e në sytë e të madhit edhe gjërat e mëdha janë të vogla.”*

Ja, ky njeri i furishëm e konsideron gjë të madhe paraqitjen e Arabëve, paraqitje kjo që nuk ka ndodhur kurrë në histori. Arabët kanë pasur rolin kryesor në kohën e tyre, kanë sunduar në tokë pa kurrfarë konkurrence tre apo katër shekuj. Pastaj,

filluan të ngecin prapa dhe pushteti i tyre gradualisht humbiste nga viset, të cilat i patën pushtuar. Kjo ka ardhur si rezultat i zemërligësisë, prishjes morale, mospërfilljes së dispozitave fetare, të dhënët pas pasioneve, e fatkeqësia më e madhe e tyre ishte grindja rreth pushtetit dhe përparësisë (veçanërisht ndërmjet kajsitëve dhe jemenitëve). Sikur të mos ishte kjo grindje, do ta zotëroni tërë Evropën dhe sot ajo do të arabe sikurse Afrika Veriore. Fatkeqësitë që i kanë goditur myslimanët, kanë ardhur me fajin e vet atyre dhe, për shkak se kanë devijuar nga rruga e drejtë, të cilën ua ka caktuar Kur'ani. Përderisa i përmbaheshin dispozitave të tij, ata përparonin dhe ngadhënjenin, kishin shtetet e veta dhe sundimin e vet. Kur filluan të shmangen nga Kur'ani dhe ta lexojnë atë, duke mos iu përmbajtur atij, të jipen pas pasioneve të veta kundër Kur'anit, ata mbaruan dhe e humbën fuqinë e madhe të tyre, andaj armiqet e tyre, së pari i pushtuan viset kufitare të shtetit të tyre, e pastaj e drejtuan shikimin e tyre në qendër.

T'i parashtroj disa shembuj me popujt e tjerë, në mënyrë që të mund të tërheqim një paralele ndërmjet nesh dhe atyre, ngase gjërat shpjegohen vetëm me kontrastet e tyre.

Para krishterimit, grekët kanë qenë popull më i zhvilluar apo njëri nga më të zhvilluarit në botë. Ata i hodhën themelet e filozofisë dhe avanconin në arsimin dhe shkencë. Kanë dhënë shumë njerëz, të cilët edhe në ditët e sotme i bëjnë dritë njerëzimit në shkencë dhe në filozofi.

Aleksandri i Maqedonisë, pushtuesi më i madh apo njëri ndër pushtuesit më të mëdhenj që i njeh historia, ka përhapur arsimimin grek, si dhe ka përhapur kulturën e grekëve ndër popujt e nënshtruar. Shteti i ptolomenjve, i cili shkëlqente në Aleksandri me shkencën dhe filozofinë e saj, është vetëm një nga mbetjet e pushtimeve të Aleksandrit. Kjo gjendje ka zgjatur përderisa grekët nuk pranuan krishterimin menjëherë pas paraqitjes së tij. Pasi që ky popull pranoi fenë e re, filloi shkatërrimi, prapambetja dhe humbja e virtyeteve të vjetra të tij. Kështu binte në dekadencë gjithnjë e më shumë nga shekulli në shekull dhe rrëzohej nga brezi në brez, gjersa Greqia nuk u bë krahinë e Perandorisë Osmane. Vetëm në shekullin e kaluar kanë përparuar diç, porse as për së afërmi nuk kanë arritur shkallën në të cilën kanë qenë para krishterimit.

A duhet tani të themi se krishterimi është përgjegjës (shkaktar) i prapambetjes së Greqisë?

Ata, të cilët konfirmojnë se Islami është shkaktar i prapambetjes së popujve, të cilët e praktikojnë atë, duhet të pranojnë se krishterimi i ka sjell grekët në prapambetje, të cilët para tij kanë qenë më përparimtarët.

Shteti i Romës ka qenë në kohën e vet sunduesi më i madh dhe më i fuqishëm në botë, gjithnjë derisa nuk e pranoi krishterimin në kohën e krishterimit. Prej asaj kohe, filloi të mbetet prapa materialisht dhe moralisht, gjersa nuk u shkatërrua së pari në Perëndim, e pastaj edhe në Lindje. Pas shkatërrimit të shtetit romak, Roma më nuk mundi ta rikthejë

famën që kishte pasur më parë dhe kaluan pesëmbëdhjetë shekuj derisa nuk arriti të ripërtërijë diç nga ajo. Edhe sot, Roma nuk e ka arritur atë shkallë në të cilën gjendej në kohën e paganizmit të tyre.

A mund të konsiderojmë se krishterizimi i romakëve ka qenë faktor, i cili ka shkaktuar dekadencën e Romës dhe rrëzimin e saj nga lartësia e madhe? Këtë e konfirmojnë shumë shkencëtarë, siç konfirmojnë ngjashëm me këtë disa të tjerë për Islamin, por që të dy grupet gabojnë dhe nuk janë duke ndjekur rrugën e drejtë.

Për rrëzimin e romakëve, pas përhapjes së krishterimit në mesin e tyre dhe rrëzimin e grekëve para tyre, meqë pranuan thirrjen e Palit në krishterim, ekzistojnë shumë shkaqe dhe faktorë. Kështu për shembull, prishja morale, rraskapitja e intelektit, përhapja e prostitucionit dhe e korrupsionit, epidemia e ateizmit dhe e shfrenimit, pleqëria shtetërore, për të cilën flet Ibën Halduni, dhe shkaqe të tjera të brendshme, të cilave duhet t'u shtohen edhe sulmet e barbarëve nga jashtë. Këtu, pra, është fjala për shkaqet e papërballuara, që kanë çuar gjer tek rënia e pashmangshme, e nëse pandehim se krishterimi atëbotë as që ishte shfaqur, romakët dhe grekët assesi nuk do të shpëtonin nga pasojat e këtyre ngjarjeve, as që do të shmangeshin nga pasojat e këtyre shkaqeve. Konfirmimi i disa historianëve evropianë se, ngadhënjimi i krishterimit mbi grekët dhe romakët e ka shkatërruar madhështinë e tyre dhe qytetërimin e tyre, është vetëm aq i saktë se, në realitet institucionet e reja i

rrëzojnë të vjetrat. Ky është ligj i Zotit në botë. Tekembramja, gjatë ndërrimit të një situatë, duhet të ketë çrregullime dhe tundje të parimeve dhe të anarkisë. Për ndryshe, askush nuk mund të pohojë se për një kulturë është më i përshtatshëm paganizmi sesa krishterimi.

Ky konfirmim është i ngjashëm me atë, kur armiq të e Islamit, pohojnë se Lindja ka notuar në kulturë, pas lindja e Islamit i shkatërroi qytetërimet e vjetra lindore. Do të ishte kështu, sikur të mos ishte e saktë ajo që përmenda se, në realitet të gjitha qytetërimet lindore kanë qenë tanimë të shkatërruara apo në dekadencë e sipër, se vetëm Islami e ka ripërtërirë qytetërimin e shkatërruar të Lindjes, ia ka kthyer fuqinë e humbur dhe i ka ngritur ato qytete përplot banorë, siç janë Bagdadi, Basra, Samarkandi, Buhara, Damasku, Kajro, Kajrevani, Kordoba etj. Edhe pse në Lindje gjendeshin mbeturina të qytetërimeve të vjetra, megjithatë, ato i kishte përforcuar Islami, duke mbajtur shpatën në një dorë e pendën në dorën tjetër, në viset më të largëta, të cilat mund vetëm t'i paramendojmë, sepse në to kurrënjëherë nuk kishte shkelur këmba e njeriu lindor.

Nëse kryqtarët evropianë nga Perëndimi dhe, mongolët porsiluzëm karkalecash nga Lindja, kanë shkatërruar atë që e ka ngritur Islami në ato vise, dhe e kanë shfarosur kulturën e atyre qyteteve; nëse grindjet e brendshme të qeverive islame, dhënia e tyre pas pasioneve, rendja e tyre në lajthitje, braktisja e rrugës së drejtë të Kur'anit dhe mungesa e moralit të lartë, të

cilin Kur'ani e mbjellë në zemrat e njerëzve; nëse e tërë kjo ka zhgërryer nga brenda atë që armiku nuk ka mundur ta shkatërrojë nga jashtë; për këtë prapambetje nuk është fajtor Islami, e as që është fajtor Kur'ani për këtë përmbysje, porse janë fajtorë barbarët evropianë, invadimi i karkalecave mongolët dhe myslimanët, përpos të rrallëve, të cilët i kanë braktisur dispozitat e Kur'anit dhe i kanë sakrifikuar ligjet e tij për gjërat e parëndësishme.

Popujt evropianë gjithashtu kanë pranuar krishterimin në shekullin III, IV, V dhe VI sipas Isait, ndërsa disa prej tyre u krishterizuan mezi në shekullin X. Evropa e arriti fuqinë e tanishme të saj, e cila gradualisht i solli famë të madhe, me ndihmën e shkencës vetëm para katërqind vjetësh, përkatësisht 700-1000 vjet pas kalimit në krishterim. Kjo periudhë në histori quhet shekulli i mesëm. Ne nuk konfirmojmë se të gjithë evropianët atëherë bredhnin në errësirë, por në bazë të pranimi të historianëve të tyre, e përkundër Luiz Bernusit dhe të ngjashmëve, konfirmojmë se arabët me kulturë kanë qenë shumë më përparimtarë. Prej veprave më të reja që dëshmojnë këtë është edhe “Historia e përgjithshme” e shkrimtarit filozof anglez Wels dhe “Historia e kulturave lindore” e historianit specialist për historinë lindore Grouse. Historia është një e vërtetë, të cilën e pranojnë të gjithë, e përkitazi me këtë çështje është vetëm një, dhe atë gjer më tani askush nuk e ka mohuar, e ajo është se Arabët në shekullin e mesëm kanë qenë mësues të

evropianëve dhe këta mburreshin ndër popullin e vet kur ndonjëri prej tyre kryente ndonjë shkollë tek arabët.

A mund të themi se prapambeturia, në të cilën gjendeshin evropianët gjatë njëmijë vjet të plota, ka rrjedhë nga krishterimi, të cilit i përmbaheshin aq fuqishëm?

Po, popujt evropianë protestantë e fajsojnë për këtë prapambeturi kishën e papës, e jo krishterimin si të tillë, dhe pohojnë se përparimi i Evropës ka filluar vetëm pas ngritjes së Lutherit dhe Kelvinit (Calvin's) kundër kishës së Romës.

Volteri (Voltaire) dhe drejtimet e ngjashme më rë tij të ateizmit nuk bëjnë dallime në mes katolikëve dhe protestantëve. Sipas mendimit të tyre, të gjitha këto janë dogma të njëjtë dhe të gjitha i kundërvihen shkencës, andaj Volteri, kur ishte fjala për Lutherin dhe Kelvinin, pat thënë: “Asnjëri prej tyre nuk mund t’i jetë Muhammedit as papuçë”. Që don të thotë se Muhammedi ka realizuar rilindje çfarë ata nuk kanë arritur as për së afërmi, edhe pse besojnë që feja e tyre ka qenë nismëtare e agimit të arsimimit në Evropë.

Është vërtetë pakontestuese se vetëm krishterimi nuk është përgjegjës për shkak të paditurisë së Evropës krishtere përgjatë njëmijë vjetësh të shekullit të mesëm, porse është meritë e krishterimit që i ka bashkuar barbarët evropianë.

Japonezët janë idhujtarë. Disa prej tyre rrëfejnë budizmin, disa i përkasin ferrëfimit tavijim, e shumë prej tyre janë ithtarë të filozofit kinez Konfuçit. Kanë kaluar mbase dy mijë vjet e që ata të mos kenë këtë qytetërim të shkëlqyeshëm e as fuqinë dhe

famën e sotme ndërkombëtare. Pas kësaj Japonia para gjashtëdhjetë vjetëve ngritet, fuqizohet, arrinë forcë dhe fuqi dhe japonezët arritën shkallën e sotme të përparimit, megjithqë ende mbetën idhujtarë. Prandaj, idhujtaria nuk ka qenë shkak i prapambeturisë së tyre në të kaluarën, e as faktor i përparimit të sotëm të tyre. Japonia dhe Rusia u ballafaquan dhe luftuan në mes veti, e Japonia doli si fitues përkundër faktit se rusët janë dy herë më shumë se japonezët, mirëpo japonezët pa dyshim janë më përparimtarë se rusët, edhe pse Rusia është e tëra e krishterë e Japonia e tërë idhujtare.

Pra, le të ndërprejmë disa njerëz ta konsiderojnë fenë si kriter të prapambetjes apo përparimit, meqë në rast të kundërt do të konfirmonim se vetë Dhijata e Re ka bërë që Rusia të mbetet e prapambetur, ndërsa adhurimi i perëndisë dielli i ka ndihmuar Japonisë ta mbikalojë Rusinë.

Këto dukuri posedojnë shumë shkaqe të ndërlikuara dhe faktorë me preardhje të ndryshme. Kur të tubohen këta faktorë në drejtim të mirë apo të keq, kur të mbizotërojnë në ndikimin e fesë dhe dogmës, atëherë edhe virtytet e fesë më të drejtë do të jenë të pafuqishme kundruall mizorisë së tyre, ashtu sikurse që të metat e fesë do të mbeten pa ndikim nëse këta faktorë janë të mirë.

Nuk kemi për qëllim që këtu t'i njehësojmë shkaqet e zhvillimit të shpejtë të Japonisë, e të sqarojmë se të besuarit e masave të gjera të tyre në ekzistimin e kalit të shenjtë në të cilin kalëron ai, dhe ai perëndi, nuk ka penguar përparimin e tyre, i

cili bazohet në kalorësinë e tyre natyrore, në mendjemprehtësinë dhe në garimin për famë dhe fuqi, e që ua ka kultivuar rregullimi i vjetër feudal.

Ne kemi në dispozicion shumë shembuj të këtillë, por mjaftojnë këta që i parashtruam më lart. As që do hynim kësaj rruge sikur shumë priftërinj, misionarë dhe shumë evropianë të mos e sulmonin Islamin duke pohuar se Islami, është karakteristikë e prapambeturisë dhe simbol i konservatorizmit kokëngjeshur. Ata, këtë e flasin nëpër klube dhe nëpër zbavitje. I parashtrojnë këto trillime nëpër revista dhe gazeta, duke pohuar se druri mund të njihet sipas frutit të tij, andaj gjendja e sotme e botës islame është rezultat i konservatorizmit kokëngjeshur dhe i fosilizimit kur'anor. ("Sa fjalë të mëdha janë këto që flasin ata; ata flasin vetëm gënjeshtër".)

Mjafton të theksojmë se zotëri Seni (Saint), guvernator francez i Afrikës Veriore, ka nxjerrë faqe bote në numrin e fundit të revistës franceze "Rimëkëmbja" një artikull për zgjimin e Afrikës Veriore pas "natës islame". Kështu, shprehet ai. Nëse prapambetja e ndonjë rajoni islam në ndonjë kohë mund të quhet "nata islame", atëherë sa është e gjatë nata e krishterimit, kur Evropa e krishterë mbase një mijë vjet vuante në barbarizëm apo në gjysmëbarbarizëm? Përse të përzihen fetë në atë për çka ato nuk janë aspak fajtores?! Përse të futen në tematikë të cilën historia e hedh poshtë me shembuj të shumtë? Të futen fetë në këtë arenë dhe, të konsiderohen ato si kritere të përparimit apo të dekadencës, nuk pajtohet fare me drejtësinë.

Të nxiturit e Kur'anit në dituri është nxitje për myslimanët që t'i tejkalojnë popujt e tjerë në zhvillim

S ikur të donin myslimanët dhe të vendosnin, do të mund të ngriteshin, të përparonin dhe t'i arrinin popujt e tjerë. Islami në këtë pikëpamje do t'ua shtonte vetëdijen dhe vendosmërinë. Ata kurrë nuk do të mund të gjenin inkurajim më të mirë sesa shkencën dhe artin e Kur'anit, në të cilin thuhet: ***“A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?!”. (Ez-Zumer: 9).*** ***“E ka pajisë atë me dijeni të gjerë.” (El-Bekare: 238).*** ***“All-llahu dëshmon se Ai është vetëm një, - por edhe engjëjt, e të diturit (e dëshmojnë këtë).” (‘Ali ‘Imran: 18).*** ***“Jo! Ai (Kur’ani) - është me argumente të qarta në zemrat e atyre që u është dhënë dija, e argumentet tona i mohojnë vetëm zullumqarët -” (El-Ankebut: 49).*** ***“All-llahu, ata nga mesi juaj, që besojnë dhe ata të cilëvet u është dhënë dijenia, do t'i ngritë në shkallë të lartë. All-llahu është i informuar se ç’punoni”. (El-Muxhadele, 11).*** ***“Dhe t’ua mësojë atyre Librin dhe t’i ofrojë dijeni të përsosur.” (El-Bekare: 129).*** ***“(All-llahu) ia jep dijeninë e hollë. E, kujtdo që i është dhënë dijenia, me të vërtetë, i është dhënë begati e pakufishme.” (El-Bekare: 269).*** ***“Na u kemi dhënë breznive të Ibrahimit Librin e dijeninë e plotë dhe u kemi dhënë pushtet të madh.” (En-Nisa’: 58).*** Ajetet që flasin për diturinë janë të shumta e të

njohura, e disa prej tyre i përkasin ekskluzivisht popullit arab, si për shembull: ***“All-llahu është Ai, që ju ka dërguar të pa arsimuarve një Pejgamber nga mesi i tyre, që ua ka lexuar atyre ajetet e Kur’anit dhe i ka pastruar (nga gjendja e gabuar), ua ka mësuar Librin (Kur’anin) dhe urtinë (dijeninë e thellë), meqë, ata më parë, në të vërtetë, kanë qenë në humbje të plotë.”*** (El-Xhumu’a: 2).

Disa thonë, e në mes tyre edhe Sicardi, ai i Afrikës Veriore - i cili ka shkruar kundër Islamit dhe i cili shkruan në revistën “Maroko katolike” (“Le Maroc catholique”), se me nocionin “dituri” në Kur’an mendohet vetëm në atë fetare, e jo dituria në përgjithësi, e që të mund të argumentohet fakti se Kur’ani e çmon diturinë dhe urdhëron arsimimin.

Përkitazi me këtë çështje Sicardi shërbehet me asi sofizma, saqë nuk meritojnë të përgjigjemi në to, ngase i injorojnë faktet. Secili që e ka vëzhguar strukturën (mbërthimin)e këtyre ajeteve (proverbave kur’anore), të cilat kanë të bëjnë me diturinë dhe përsiatjen, e din se këtu me nocionin dituri nënkuptohet dituria në përgjithësi, çkadoqoftë të studiojë ajo, e me nocionin urtësi nënkuptohet urtësia shkencore, në kuptimin e thjeshtë të fjalës, e nuk synohen Shpalljet e Zotit apo Kur’ani, siç shihet nga vet lidhëza, e cila kërkon llojllojshmëri. Këtë e përforcon edhe hadithi i njohur: *“Kërkoni dituri madje edhe në Kinë”*. Sikur me dituri të mendohej në diturinë fetare, siç pohon Sicardi, nuk do të nxiste i Dërguari i Zotit që ajo të kërkohet edhe në Kinë, ngase kinezët janë idhujtarë, andaj

është e qartë se i Dërguari i Zotit nuk do të preferonte që për dituri fetare tu drejtohem i atyre.

Në disa proverbe Kur'anore ekzistojnë rrethana përmbajtëse gjuhësore, të cilat kërkojnë që me dituri të nënkuptohen shkencat natyrore, ngase ky nocion mbërthehet në proverbat mbi krijimin e botës. Këso proverbash ka disa herë më shumë sesa ato që flasin për ritualet trupore, siç është namazi dhe agjërimi. Ja një shembull: ***“Vallë, a nuk di ti, që All-llahu e lëshon ujin prej qiellit, e që Ne, me të krijojmë fryte llojesh e ngjyrash të ndryshme; e nëpër male gjenden rrugë të bardha dhe të kuqe, ngjyrash të ndryshme, dhe krejtësisht të zeza. Ka edhe njerëz, edhe shtazë, edhe bagëti - po ashtu llojesh të ndryshme. Me të vërtetë, All-llahut i druajnë vetëm të dijsmit prej robërve të Tij”*** (El-Fatir: 27-28), përkatësisht ata që e njohin ujin, bimësinë, malet, mbretëritë e llojllojshme natyrore dhe fshehtësitë e tyre natyrore, për të cilat flitet në proverbat kur'anore, e jo vetëm ata që e njohin namazin, agjërimin etj.

Ne e konsideronim Sicardin sado-kudo njeri që e donte të vërtetën, andaj kur e mohoi qytetërimin islam, iu përgjigjëm në “El-Menar” dhe polemizuam me të në mënyrë të denjë, e nderuam atë dhe ua rrëzuam pohimin e evropianëve, të cilët konsiderojnë se krishterimi ka qenë pengesë e rrjedhë së qytetërimit dhe shkak për shkatërrimin e grekëve dhe romakëve etj. Në këtë Sicardi, shkruan një sërë artikujsh me anë të cilëve e sulmon Islamin, e sikur të dëshironim t'i rrëzojmë

konfirmimet e tij, nuk do të mundemi e të mos i spikatim disa dyshime dhe vërejtje që kanë të bëjnë me krishterimin. Mirëpo, ne heqim dorë nga kjo, meqë nuk është e drejtë, e mençur e as e hijshme që t'i provokojmë miqtë tanë të krishterë, për shkak të njeriut i cili quhet Sicard, apo të ndonjë propagatori tjetër ose misionari të këtij lloji. Këtë e parashtrojmë si shtojcë absurditeteve, inkoherencave (palidhshmërive) dhe sofizmave të cilat i kam vërejtur në konfirmimet e tij, siç është për shembull se dituria që e mendon Kur'ani, nuk është ajo që bota e quan ashtu në domethënien e përgjithshme të kësaj fjale, porse kjo është vetëm dituri fetare, meqë Kur'anit nuk i intereson kurrnjë dituri e kësaj bote. Një injoranti të këtillë nuk meriton t'i përgjigjemi fare.

Më vonë kuptuam se zotëri Sicardi është funksionar francez në Rabat në Byronë për Punët Islame, dhe se ai, zotëri Louis Bernus - administrator i arsimit të atjeshëm, komandanti Marcon - administrator për censurimin e gazetarisë dhe shtypit, komandant Marti - këshilltar i jurisprudence islame e të tjerë, kanë luajtur rolin më kryesor përkitazi me çështjen e aksionit për krishterizimin e berberëve. Franca i ka përdorë ata për punë, të cilat ekskluzivisht kanë të bëjnë me Islamin në Afrikën Veriore. Franca, herët a vonë do t'i shijojë pasojat e kobshme të kësaj veprimtarie kundër Islamit, të cilën ishte obliguar se do ta respektonte, sipas kontratave të veta.

Disa thonë: “Përse t'i kthehemi Kur'anit për zgjimin e vullnetit për dituri te myslimanët? Lëvizja nuk duhet të jetë

fetare, por patriotike-nacionale, siç është tek evropianët.” Ne u përgjigjemi se kryesorja është që lëvizja, qoftë ajo patriotike apo fetare, të ketë për qëllim forcimin e intelektit në fushën shkencore.

Mirëpo, ne frikësohemi se , po qe se kjo lëvizje ndahet nga Kur’ani, do të na shpiente në ateizëm dhe indiferencë, në adhurimin e trupit dhe në pasimin e pasioneve, që shkakton më tepër dëm sesa dobi. Pra, ne na nevojitet një arsimim shkencor, i cili do të shkonte paralelisht me atë fetar.

A mos vallë, njerëzit tanë nga Perëndimi mendojnë se ka ndodhur ndonjë lëvizje pa arsimimin fetar? A nuk ka thënë para tri vitesh kryeministri gjerman: “Arsimimi ynë bazohet në krishterim.” Ja, kështu deklaroi Gjermania, e cila konsiderohet si idol në shkencë, teknikë, fuqinë e armëve dhe pajisjeve, që nuk mund t’ia mohojë askush, madje as armiqtë e saj. A ekziston në Gjermani, në Angli apo në ndonjë shtet tjetër ndonjë universitet, e që në të, të mos ligjërohet teologjia krishtere? Krahës kësaj, në Evropë “Lëvizja Atdhedashëse” apo “Lëvizja Popullore”, “Bashkia Patriotike apo Popullore”, me nocionin “atdhe” nuk mendojnë në tokën, ujin, drunjtë apo gurët, e as me nocionin “popull” në pasardhësit që rrjedhin nga gjaku i njëjtë. Fjala atdhe dhe popull tek ata janë dy shprehje të cilat do të thonë atdheun dhe popullin së bashku me karakteristikat gjeografike, historike, shkencore, kulturore, dogmatike, fetare, morale dhe zakonore. Këto janë të gjitha ato

për të cilat ata luftojnë dhe për shkak të të cilave tregojnë aq trimëri.

Myslimanët janë të obliguar të luftojnë me pasurinë e tyre dhe me shpirtin e tyre, në mënyrë që ta mbledhin veten, të lartësohen në famë dhe të përparojnë, ashtu siç kanë përparuar popujt e tjerë. Këtë luftë e urdhëron Kur'ani në shumë vende dhe, kjo është ajo që sot quhet vetëmohim (gatishmëri për sakrificë). Pa vetëmohim assessi nuk është e mundur që myslimanët apo ndonjë popull tjetër të kenë sukses e as të përparojë.

Ndoshta Shejh Muhammed Bisjuni Imran, apo ndokush tjetër që kërkon mendimin tonë përkitazi me këtë lëndë, ka menduar se gjithsesi do t'i përgjigjem se çelësi për zhvillim është të studiohet teoria e relativitetit e Einsteinjit, rrezet e Röntgenit (Roentgenit), mikrobet e Pasteurit, përdorimi i valëve të ulëta e jo të larta te telefoni patel, studimi i shpikjeve të Edisonit dhe se shkak i rrëzimit të aeroplanit anglez, i cili tani rishtas është rrëzuar dhe është djegur, është se nuk ka qenë i mbushur me helium por me hidrogjen, sepse hidrogjeni, ndonëse është më i lehtë, mund të ndizet, ndërsa te heliumi nuk ekziston kjo druajtje, edhe pse është diç më o rëndë se hidrogjeni, e kështu me radhë. Në të vërtetë, këto gjëra janë vetëm me karakter dytësor e jo parësor. Ato janë pasoja e jo shkaqe, ndërsa vetëmohimi dhe lufta me pasuri dhe me shpirt (jetë) janë dituria më e madhe. Kur populli arrin te ky

konceptim dhe vepron sipas tij, shkencat e tjera do t'i arrijnë lehtë dhe do t'i vjelë frytet e tyre.

Për të kuptuar nevojën, nuk është e obligueshme të dihet se si të eliminohet ajo. Me një rast filozofi perëndimor Es-Sejjid Xhemaludin Afgani më tha: “Babai përdëllimtar mund të jetë edhe injoranti më i madh, por kur t'i sëmuret djali, e zgjedh mjekun më të aftë dhe e di se kjo është diç e mirë, e kjo është shkencë për të cilën ai nuk di asgjë, mirëpo nga dëshira për ruajtjen e jetës së djalit e di se ajo është e nevojshme.”

Mehmed Aliu nuk ka qenë i arsimuar, ndoshta ka qenë edhe analfabet, por për një kohë të shkurtër e ka ngritur Egjiptin nga letargjia dhe në kohën e vet ka bërë që ai të jetë njëri ndër shtetet e mëdha, me ndihmën e asaj dijenie, e cila quhet vullnet dhe e cila edhe individin edhe popujt i nxitë në studimin e shkencave.

Pra, myslimanët, nëse dëshirojnë, nëse vendosin dhe nëse veprojnë sipas intencave të Kur'anit, mund të arrijnë shkallën e zhvillimit të Evropës, të Amerikës dhe të Japonisë në shkencë dhe në përparim e të mbeten në Islam, ashtu siç kanë mbetur edhe ata në fetë e tyre. Myslimanët janë më të denjë dhe më të përshtatshëm për këtë, ngase janë njerëz sikurse edhe ata, vetëm që i mungojnë veprat dhe u dëmton parandjenja e keqe, plogështia dhe pashpresa. Ta shkundim pluhurin e dëshprimit, të marshojmë përpara të bindur se do të realizojmë çdo dëshirë me punë, me përpjekje, me vendosmëri dhe me përmbushjen e kushtit të besimit ndaj fjalëve të Kur'anit: ***“E ata, të cilët bëjnë***

luftojnë për hir Tonë, Ne, me siguri, do t'i udhëzojmë në rrugën Tona. All-llahu, me të vërtetë, është në anën e bamirësve". (El-Ankebut: 69).

L

ausane, më 11 nëntor 1930

Emir Shekib Arslan

Sipas prejardhjes - patric (emir), sipas bindjes - luftëtar i patrembur në rrugën e All-llahut xh.sh. (*muxhahid*) dhe në fushëbetejë, sipas thirrjes (profesionit) - publicist i angazhuar islam, letrar dhe historian, sipas stilit të shkrimit - princ i fjalës dhe i pendës, e krahas të gjitha këtyre - kryepar dhe udhëheqës i vërtetë i myslimanëve, Emir Shekib Arslani i takon, padyshim, personaliteteve më markant gjysmës së parë të shekullit nëntëmbëdhjetë.

Është lindur më 1. ramazan të vitit 1286 sipas hixhretit (më 5. dhjetor të vitit 1869 sipas Isait a.s.) në qytetin Libanon Shuvejfat. Në vendlindje mbaron shkollën fillore (*ibtidaijja*), ndjek liceun shtatëklasësh të maronitëve të atjeshëm, ndërsa studimet i vazhdon në "Sulltaniyje" të Bejrutit, ku i dëgjon shkencat juridike nga goja e njërit prej autoriteteve më të mëdhenj islamikë - Shejh Muhammed Abduhui.

Pas mbarimit të studimeve emërohet udhëheqës (*mudir*) i provincës Shuvejfat, mirëpo pas dy vitesh e lëshon pozitën dhe vete në Bejrut, ku i përkushtohet tërësisht punës shkencore dhe letrare. Ndërkaq, ngjarjet politike së shpejti e detyrojnë që përsëri të pranojë shërbimin shtetëror, andaj gjatë trazirave në Liban gjatë tri viteve ushtron funksionin e mëkëmbësit (*kajmakan*), pastaj të deputetit popullor në parlamentin turk (*mexhlisu 'l-mebusan*), për provincën Havran. Gjatë Luftës Ballkanike punon në Gjysmëhënën e Kuqe (*hilal ahmer*) rreth kujdesjes së refugjatëve të luftës, ndërsa gjatë Luftës së Parë Botërore dy herë udhëton për në Gjermani, si përfaqësues i qeverisë turke me detyra të rëndësishme shtetërore. Në Berlin qëndron pesë muaj, duke u përpjekur që të ndihmojë në zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme, siç është për shembull konflikti i Turqisë dhe Gjermanisë rreth Bakuasë. Pas përfundimit të luftës përsëri kthehet në Berlin, pastaj udhëton për në Lozanë dhe Paris, duke u takuar për çdo ditë me shumë burrështetasë dhe politikanë të asaj kohe. Në të gjitha këto aktivitete Emir Arslani kishte para vetes vetëm një cak: t'i çlirojë popujt islamë nga pushteti turk. Për këtë qëllim udhëton edhe në Rusinë bolshevike, ku takohet me Leninin dhe me Trockin. Në vitin 1927 shkoi në Amerikë me dëshirë që të njoftohet me rrethanat në të cilat jetonin myslimanët e atjeshëm, numri i të cilëve ishte mjaft i madh, posaçërisht në Brazil. Kjo vizitë zgjatë plot pesë muaj. Në këtë dritë, duhet shikuar edhe vizitën e tij, që u ka bërë myslimanëve të viseve

tona, dhe atë dy herë: në vitin 1932 dhe 1936. Me rastin e vizitës së parë atdheut tanë, ai vizitoi Posavinën, Hercegovinën dhe një pjesë të Bosanska Krajinės. Numrin më të madh të këtyre vizitave, Emir Shekib Arslani ka mundur t’i realizojë, duke i falënderuar qëndrimin e tij në Gjenevë, ku e kaloi një të katërtën e shekullit në cilësi të delegacionit siriano-palestinez, ku në kuadër të Ligës së Kombeve i përfaqësonte dhe i mbronte interesat e myslimanëve. Më në fund kthehet në Bejrut, prej nga i nisë udhëtimet e veta të shumta nëpër botë, në mënyrë që në vitin 1946 të transferohet në Ahiret.

Emir Shekib Arslani ka vepruar me arsye dhe zemër të plotë në të gjitha fushat e jetës njerëzore: nga ato politike, sociologjike dhe ekonomike gjer te kulturore dhe arsimore. Ekzistojnë shumë gjurmë të tij, që e vërtetojnë këtë. Por edhe dëshmi të shkruara: nga veprat e përpiluara në shumë vëllime gjer te artikujt e shkurtër dhe vështrimet gazetare. Sesa ka qenë i angazhuar, vetëm si gazetar për shembull na flasin të dhënat se gjatë vitit 1931 i ka botuar 250 tekste me përmbajtje të ndryshme, ndërsa sesa ka qenë i pranishëm në rrjedhat e përditshme na flet fakti se korrespondenca e tij vjetore përmbanë mbi 2.500 shkresa (letra) të ndryshme. Krahas këtij angazhimi tejet të madh, ai redakton edhe revistën “La Nation Arabe” - organ i delegacionit të përmendur siriano-palestinez, ndërsa në Damask ushtron funksionin e kryetarit të Akademisë Arabe të Shkencave dhe përsëri është i pranishëm në faqet e revistave dhe gazetave të shumta të asaj kohe, edhe arabe edhe joarabe,

por edhe në të tonat ku janë botuar disa studime dhe artikuj të tij, për çka do të ketë më tepër detaje në fund të kësaj ekspozije të shkurtër të jetës dhe punës së tij.

Sipas shumicës, veprat më të rëndësishme të tij - e që njëkohësisht më voluminoze - janë ato që kanë të bëjnë me gjendjen e myslimanëve në shtetet dhe viset që i kishte vizituar vet apo për të cilat kishin shkruar të tjerët, e që ky në këto shkrime të japë vështirime kritike. I tillë është për shembull vështirimi i tij kritik i gjerësishëm në njërën nga veprat më të mëdha enciklopedike arabo-islamike të asaj kohe - *“Hadirul-alemil-islamijji”* (Bota e tanishme islame), nga orientalisti amerikan L. Studard, e që në gjuhën arabe e ka përkthyer ‘Uxhaxh Nuvejhid në vitin 1935. Kjo enciklopedi tipike mbi Lindjen e Afërt dhe popullatën e saj, mbi të kaluarën e shkëlqyeshme të saj, por edhe mbi të tanishmën e zymtë të saj, përveç informatave të çmueshme përmban edhe një sërë të tërë konkludimesh të gabuara gjer te të cilat vjen autori i saj, e Emir Shekib Arsllani përpiqet t’i tregojë sheshit ato dhe burimin e mundshëm të tyre, duke shfrytëzuar njëkohësisht rastin që në mënyrë kritike t’i shqyrtojë qëndrimet e disa misionarëve dhe orientalistëve të krishterë. Ndër veprat e tij më voluminoze bën pjesë *“El-Hullelu es-sundusijjet filahbari vel-asari el-endelusijjeti”* që përfshin dhjetë vëllime, mbi myslimanët tanë në Endelus (Spanjë), për të kaluarën e tyre të shkëlqyer, të cilët në fushën e kulturës intelektuale dhe materiale kanë realizuar atë që, kurrnjë popull evropian

asokohe nuk ka mundur të realizojë, duke treguar sheshit njëkohësisht shkaqet e shkatërrimit të myslimanëve andaluzianë, kur më në fund shkatërrohet edhe shteti i tyre me çka definitivisht kjo krahinë bëhet “parajsë e humbur” e myslimanëve. Gjithashtu, me vlerë të madhe është edhe vepra e tij, e cila flet për ekspeditat ushtarake arabe në Francë, Zvicër, Itali dhe ishujt mesdhetarë (*“Tarihu gazevatil-arabi li Faransa ve Svisara ve Italia ve xhezairil-bahril-mutevessiti*), meqë përmban të dhëna të shumta për këto vise dhe për aktorët e ngjarjeve.

Emir Shekib Arslani, shkroi edhe disa studime mbi bashkëkohësit e vet, të cilët i njihte personalisht, siç janë poeti Ahmed Shevki (1868-1932), komentuesi i njohur i Kur’anit Reshid Rida (1865-1935), historiani i madh Ibën Haldun (1332-1406), pastaj letrari francez Anatol Frans (1844-1924).

Emir Shekib Arslani është marrë edhe me punë të përkthimit, duke përkthyer nga gjermanishtja, anglishtja dhe frëngjishtja, të cilat, krahas turqishtes dhe, gjithsesi arabishtes, i ka njohur mirë. Përktheu edhe veprën e Shatobrianit, një lloj romani, i cili flet për ditët e fundit të pushtetit mysliman në Endelus, e që është botuar në Aleksandri në vitin 1897 me titullin *“Rivajetu ahiri Serraxh”*. Këtë përkthim e ka shoqëruar me një koment, ndërsa në fund të veprës ka dhënë historinë e shkurtër të arabëve në Endelus.

Është marrë edhe me poezi. Divani (tufa) i vjershave të tij është botuar në vitin 1936 (?), në të cilën është përfshirë edhe

një vjershë nga njëmbëdhjetë dyvargjesh, të cilën e pat dërguar si përgjigje në letrën nga Shakir ef. Mesihiviqi, anëtar i Ulema-mexhlisit në pension. Në këtë vjershë, përmend vizitën Bosnjës dhe pritjen imponante që i patën përgatitur myslimanët e Bosnjës.

Emir Shekib Arsllani ka shfaqur mendimin (gjykimin) e vet mbi ngjarjet dhe njerëzit e kohës së tij në “Memoaret” (“Kujtimet”) e veta, të cilat përmbajnë shumë informata të vlefshme, në bazë të të cilave mund të vlerësohet si autori ashtu edhe koha e tij dhe aktorët e saj.

PËRMBAJTJA

<u>Parathënie</u>	3
<u>Letra e shejh Muhammed Bisjuni Imranit</u>	5
<u>Përgjigjja e Emir Shekib Arslanit</u>	7
<u>Shkaqet e përparimit të myslimanëve në të kaluarën</u>	9
<u>Krahasimi mes myslimanëve të sotëm dhe evropianëve</u>	14
<u>Shkaqet kryesore të prapambetures së myslimanëve</u>	39
<u>Qytetërimi islam</u>	72
<u>Përgjigjja injorantëve dhe ziliqarëve të qytetërimit islam</u>	75
<u>Të nxiturit e Kur'anit në dituri është nxitje për myslimanët që t'i tejkalojnë popujt e tjerë në zhvillim</u>	85
<u>Emir Shekib Arslan</u>	92
<u>PËRMBAJTJA</u>	99